

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

**Reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë që
preknin komunitetet e Kosovës dhe roli i Këshillave
Komunalë për Siguri në Bashkësi**

Dhjetor, 2011

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE	3
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	5
3. INCIDENTET E SIGURISË QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË NË KOSOVË – PASQYRË RAJONALE	7
3.1. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane.....	7
3.2. Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica.....	10
3.3. Rajoni i Pejës/Peć	12
3.4. Rajoni i Prishtinës/Priština.....	14
3.5. Rajoni i Prizrenit	16
4. KËSHILLAT KOMUNALË PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKS) – REAGIMET KOMUNALE NË INCIDENTET E SIGURISË QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË	17
4.1. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane.....	18
4.2. Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica.....	21
4.3. Rajoni i Pejës/Peć	22
4.4. Rajoni i Prishtinës/Priština.....	25
4.5. Rajoni i Prizrenit	27
5. PËRFUNDIM	30
6. REKOMANDIMET.....	32
SHTOJCA I: PASQYRË E KËSHILLAVE KOMUNALË PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKS).....	34

LISTA E SHKURTESAVE

EULEX	Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
KKMPK	Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare
KLSP	Këshillat Lokalë për Siguri Publike
KKSB	Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
UAM	Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë
UNHCR	Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport dokumenton dhe vlerëson reagimet e komunave ndaj incidenteve të ndërlidhura me sigurinë, të cilat prekin komunitetet jo-shumicë¹. Një “incident i rëndë i sigurisë” kategorizohet si i tillë nëse ka potencial për të destabilizuar situatën e sigurisë si dhe përfshin sulmet verbale apo fizike ndaj personave, pronës private dhe objekteve të rëndësishme kulturore dhe fetare.

Incidentet e sigurisë kanë ndikim negativ në sigurinë aktuale dhe të perceptuar të komuniteteve, si dhe mund të kufizojë lirinë e tyre të lëvizjes dhe qasjen e tyre në të drejtat dhe shërbimet thelbësore. Gjithashtu, incidentet e sigurisë kanë potencial që të nxisin tensione ndëretnike, si dhe t’i minojnë raportet ndërmjet komuniteteve jo-shumicë dhe institucioneve. Megjithatë, gjetjet e këtij raporti sugjerojnë se këto efekte negative mund të zbuten nëse autoritetet komunale reagojnë në mënyrë adekuate dhe në kohë ndaj incidentit në fjalë, për shembull përmes dialogut në forume përkatëse, deklaratave publike që dënojnë aktet e dhunës dhe komunikimit me komunitetin e prekur.

Gjatë periudhës së raportimit, komunitetet joshumicë në Kosovë vazhdojnë të ndikohen negativisht nga incidentet e sigurisë që shënjestrojnë personat, pronat private dhe monumentet me rëndësi kulturore dhe fetare. Disa komuna kanë filluar të bëjnë reagime proaktive ndaj incidenteve të sigurisë, kryesisht përmes dënimit zyrtar dhe aktiviteteve sensibilizuese që kanë për cak komunitetin e prekur. Për më tepër, aty ku zhvilloheshin këto aktivitete kishte reflektim të qartë në perceptimet e komunitetit për sigurinë e tyre, ku komunitetet raportnin se perceptimet e tyre të sigurisë janë përmirësuar.

Përkundër këtyre shembujve pozitivë, reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë përgjithësisht janë bërë në baza *ad hoc*, pa vazhdimësi të qasjes mes komunave. Veç kësaj, shumë komuna nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre në lidhje me themelimin dhe përbërjen e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, shumë komuna vazhdojnë të çalojnë në këtë drejtim, posaçërisht në çështjen e përfaqësimit të komuniteteve.

Aty ku komunat kanë reaguar ndaj incidenteve të sigurisë, përfaqësuesit e komunave kanë vërejtur një varg problemesh të vazhdueshme. Për shembull, në disa raste deklaratat publike të zyrtarëve komunalë nuk janë përkthyer në gjuhët e komunitetit joshumicë dhe kështu ato nuk ishin të qasshme për komunitetin e prekur nga incidenti. Pastaj, aty ku autoritetet komunale kanë dënuar një incident të sigurisë që prekte një komunitet jo-shumicë, komuniteti i prekur i konsideronte veprimet e tilla si kryesisht simbolike përveç nëse nuk shoqëroheshin me një fushatë sensibilizuese dhe aktivitete të dialogut.

Duke pasur parasysh korrelacionin pozitiv të shfaqur ndërmjet reagimeve adekuate dhe në kohë të komunës ndaj incidenteve të rënda të sigurisë dhe perceptimeve të sigurisë

¹ Për qëllime të këtij raporti, komunitetet joshumicë janë komunitetet në pakicë numerikë në cilëndo komunë. Ky raport hedh vështrim në incidentet e sigurisë që prekin komunitetet joshumicë. Në shumicën e komunave të Kosovës, shqiptarët përbëjnë shumicë. Raport gjithashtu hedh vështrim në incidentet e rënda të sigurisë në komunat ku serbët janë shumicë, edhe nëse viktimat është nga komuniteti shumicë.

nga radhët e komunitetit të prekur, palët e interesit duhet të punojnë së bashku për të zhvilluar një qasje konsistente. Kjo do të ndihmohej me zhvillim të mëtejshëm dhe zbatim të plotë të kornizës ligjore dhe rregullative, gjegjësisht Ligjit për Policinë dhe udhëzimeve përcjellëse administrative. Autoritetet komunale kudo në Kosovë duhet ta shfrytëzojnë mekanizmin e KKSB-ve për të zbatuar një qasje të praktikës më të mirë, gjatë reagimeve ndaj incidenteve të sigurisë përmes dënimit publik dhe fushatave sensibilizuese për komunitetet e prekura.

Ky Raport bazohet në aktivitetet e monitorimit të rregullt të Misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë periudhës janar deri dhjetor 2010. OSBE-ja vazhdon të monitorojë, raportojë dhe përcjellë reagimet e komunave ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet joshumicë, me vëmendje të shtuar pas incidenteve që filluan në fund të korrikut 2011.

1. HYRJE

Ky raport shtjellon incidentet e rënda të sigurisë që prekin komunitetet joshumicë në Kosovë dhe vlerëson reagimet përkatëse të mekanizmave në nivelit lokal të sigurisë në bashkësi, veçanërisht këshillat komunale për siguri në bashkësi (KKSBB-të).² Aty ku ato ishin të themeluara, luanin rolin e institucioneve primare lokale të mandatuara për të trajtuar sigurinë e komuniteteve joshumicë jashtë akterëve të rregullt të sigurisë dhe të drejtësisë siç janë policia e Kosovës dhe gjyqësori. Në formë të organeve kryesore konsultative të një komune për trajtimin e çështjeve të sigurisë që prekin komunitet, KKSBB-të do të themelohen në çdo komunë dhe duhet të sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha “komuniteteve etnike” që banojnë në atë komunë, si dhe hisedarëve të tjerë përkatës³

Për qëllime të këtij raporti, “incidenti i rëndë” kategorizohet si i tillë nëse ka potencial të destabilizojë situatën e sigurisë duke prekur sigurinë reale/apo të perceptuar të komuniteteve, shkurtuar lirinë e lëvizjes dhe si rrjedhojë gëzimin e të drejtave të tjera themelore, dhe/apo minuar marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Ato përfshijnë sulmet fizike ndaj personave, pronës private apo objekteve të rëndësishme kulturore dhe fetare në Kosovë, pavarësisht nëse veprimi përbën vepër penale të përcaktuar me ligj.

Në kuptim të “reagimeve”, ky raport mëton të trajtojë reagimet e “buta” të mekanizmave komunalë të sigurisë ndaj incidenteve të sigurisë, ndryshe nga reagimet policisë së Kosovës apo gjyqësorit.⁴ Këto reagime “të buta” përfshijnë deklarata të dënimeve publike, vizita sensibilizuese për komunitetin e prekur, si dhe diskutime të incidenteve nga ana mekanizmave komunalë për siguri, mes tjerash.

Raporti përqendrohet në ndikimin e tyre në perceptimin e komuniteteve përkatëse dhe në reagimet përkatëse të mekanizmave komunalë të sigurisë. Si i tillë, ai drejtohet nga dy pyetje qendrore.

² KKSBB-të janë organe të obligueshme komunale, të themeluar me Ligjin nr. 03/L-035 për Policinë, 15 qershor 2008. Sipas nenit 7(3), një KKSBB është “organ këshillues i kryesuar nga kryetari i Komunës me anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës”; neni 7(4) saktëson se ai është i mandatar që “ta zhvillojë vetëdijësimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t’i identifikojë brengat lidhur me sigurinë publike dhe t’i rekomandojë planet e veprimit, për t’i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe Policisë”. Diskutime më të hollësishme për KKSBB-në janë paraqitur në Pjesën e Katërt.

³ Shih nenin 1 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2009 MIA- 02/2009 MAPL për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, 20 mars 2009.

⁴ OSBE-ja monitoron dhe vlerëson incidentet ndëretnike, etnikisht të motivuara dhe krimet e mundshme të urrejtjes në baza të rregullta si pjesë e mandatit të saj për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e të gjitha komuniteteve të Kosovës. Aktivitetet në këtë kuptim përfshijnë punën e ekipeve në terren të cilët takohen rregullisht me përfaqësues të komuniteteve joshumicë dhe autoritetet komunale të Kosovës; monitorimi i sistemit ligjor të gjyqësorit, prokurorisë dhe gjykatave; dhe raportimi konfidencial, avokimi dhe ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit. Disa shembuj të kohëve të fundit të aktiviteteve në këtë temë përfshijnë raportimin ditor dhe komunikimin me komunitetet në tërë Kosovën në lidhje me incidentet e sigurisë pas ngjarjeve të vitit 2011 në Kosovën veriore; zhvillimi i tabelave përcjellëse për të monitoruar krimet e mundshme të urrejtjes; dhe publikimi i raportit të OSBE-së, *Kroatët e Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina: Komunitet i Cënueshëm*, nga radhët e publikimeve tjera që trajtojnë çështjet e sigurisë.

- Së pari, a janë duke i përmbushur mekanizmat komunale të sigurisë obligimet e tyre ligjore për të mbrojtur dhe promovuar sigurinë e komuniteteve të tyre joshumicë? Kjo do të përcaktohet në ndërlidhje me kornizën e aplikueshme ligjore dhe rregullative.
- Së dyti, sa efektive janë reagimet aktuale komunale në promovimin e sigurisë reale dhe të perceptuar të komuniteteve joshumicë? Për ta vlerësuar këtë, raporti do të përfshijë edhe informata të mbledhura gjatë intervistave me viktimat e incidenteve të raportuara dhe/apo me përfaqësues të komuniteteve të prekura.

Struktura e raportit është si në vijim:

- Pjesa e Dytë paraqet kornizën përkatëse ligjore dhe institucionale, duke identifikuar organet kryesore komunale të cilat janë të ngarkuara me mandat të drejtpërdrejtë për të mbrojtur dhe promovuar sigurinë e komuniteteve joshumicë, mekanizëm kryesor i së cilës janë KKSBB-të.
- Pjesa e Tretë paraqet hollësi të incidenteve të rënda të sigurisë që prekin komunitetet joshumicë në secilin nga pesë rajonet e Kosovës, duke i analizuar reagimet komunale ndaj tyre. më tej, raporti shqyrton reagimet e komuniteteve nda këtyre përgjigjeve zyrtare, për të matur efektivitetin e organeve komunale në avancimin e situatës reale apo të perceptuar të sigurisë së komuniteteve joshumicë.
- Pjesa e Katërt vlerëson funksionalitetin dhe performancën e KKSBB-ve përmes dy aspekteve kryesore të punës së tyre: 1) pajtueshmëria me obligimet e tyre sipas kornizës ligjore, me theks të veçantë në pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë; dhe 2) efektiviteti i tyre në promovimin e sigurisë në radhët e komuniteteve joshumicë, veçanërisht përmes kapacitetit të tyre për të trajtuar dhe reaguar ndaj incidenteve të sigurisë që kanë për cak komunitetet.⁵

Ky raport bazohet në aktivitetet e monitorimit të rregullt të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në periudhën ndërmjet janarit dhe dhjetorit 2010, si dhe në intervistat e kryera me zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të komuniteteve gjatë po kësaj periudhe, përfshirë edhe përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të të gjitha KKSBB-ve të themeluara. Siç është theksuar më lart, intervistat janë kryer edhe me viktimat e incidenteve të raportuara dhe/apo me përfaqësuesit e komuniteteve të prekura për të identifikuar ndikimin e incidenteve në sigurinë e komuniteteve si dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Ndonëse gratë nga komunitetet jo-shumicë janë mjaft dobët të përfaqësuara në organet komunale dhe në forume të fshatrave dhe lidërshpit të komunitetit, OSBE-ja ka përfshirë perspektivën e femrave në vlerësim kudo që kjo ishte e mundur. Përgjithësisht, janë kryer 108 intervista individuale të gjysmë-strukturuara⁶, përfshirë 36 me viktimat e incidenteve të sigurisë dhe/apo

⁵ Ky raport nuk vlerëson rolin e forumeve tjera lokale të sigurisë siç janë Këshillat Lokalë për Siguri Publike (KLSP-të), të rregulluar me neni 7(3) të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë, 4 qershor 2008; Ekipet Vepruese të Sigurisë në Bashkësi, të cilët janë themeluar në bashkëpunim me Departamentin e Shtetit të SHBA-së në disa komuna për të promovuar veprimet policore të bazuar në komunitet, apo takimet tjera të sigurisë të organizuar nga akterë të sigurisë siç janë KFOR-i apo EULEX-i.

⁶ Intervistë gjysmë e strukturuar është metodë hulumtimi që përdoret në shkencat sociale. Përderisa një intervistë strukturuar ka një varg të formalizuar dhe të kufizuar pyetjesh, intervista gjysmë e strukturuar është fleksibile, duke lejuar shtimin e pyetjeve të reja gjatë intervistës si rrjedhojë e asaj që është përgjigjur i intervistuari.

përfaqësuesi të komuniteteve që janë prekur (dy nga ta ishin femra), dhe 72 pjesëtarë të organeve të ndryshme komunale nga komunitetet joshumicë (pesë nga ta ishin femra).

OSBE-ja vazhdon të monitorojë, raportoje dhe përcjellë reagimet e komunave ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet joshumicë, me vëmendje të shtuar në ngjarjet pas fundit të korrikut 2011.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Konventa Evropiane Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK) përcakton disa nga standardet kryesore ndërkombëtare normative për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë.⁷ Ajo bën thirrje për institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin “masa të duhura” për mbrojtjen e personave nga kërcënimet, armiqësia, dhuna apo diskriminimi si rrjedhojë e identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, duke inkurajuar një frymë të tolerancës dhe dialogut ndërkulturor përmes “masave efektive” për promovimin e respektit reciprok, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Ndonëse KKPK nuk cek se çka përbën masë efektive dhe/apo të duhur, ajo e bën lidhjen vendimtare ndërmjet promovimit të sigurisë dhe avancimit të tolerancës ndërmjet komuniteteve.⁸ KKPK është drejtpërsëdrejti e aplikueshme me ligjet e Kosovës.⁹ Korniza ligjore gjithashtu përfshin dispozita speciale që nxisin institucionet e Kosovës të mbrojnë sigurinë e komuniteteve. Për shembull, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre ngarkon institucionet që t’i “ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme” për të mbrojtur ata të cilët mund t’i nënshtrohen kërcënimeve, armiqësive apo dhunës si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Gjithashtu, ky Ligj i obligon at që të promovojnë paqen, tolerancën, dialogun ndërkulturor dhe ndërfaqësor, si dhe të promovojnë pajtimin ndërmjet komuniteteve.¹⁰

Ndonëse korniza ligjore bën lidhjen e rëndësishme ndërmjet promovimit të sigurisë dhe promovimit të paqes, ajo nuk përshkruan për institucionet llojet e masave apo aktiviteteve që do të çonin në mbrojtjen dhe promovimin e sigurisë së komuniteteve joshumicë, si dhe nuk përcakton organet apo mekanizmat specifikë për ndërmarrjen e këtyre masave. Gjersa Ligji për vetëqeverisjen lokale delegon kompetenca te komunat¹¹, ai nuk ofron asnjë udhëzim specifik në lidhje me sigurinë e komuniteteve jo-shumicë. Për më tepër, gjatë verës së vitit 2011, Ministria e Punëve të Brendshme aprovoi “Strategjinë Nacionale dhe Planin e veprimtimit për Siguri në Bashkësi 2011–

⁷ Shih Konventën Evropiane Kornizë për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave (KKPK), të Këshillit të Evropës, shkurt 1995. KKPK ka për qëllim të sigurojë se shtetet nënshkruese respektojnë të drejtat e pakicave të tyre kombëtare brenda sistemeve të tyre ligjore dhe politike. Deri më 2011, ajo është ratifikuar nga 39 shtete anëtare të Këshillit të Evropës. Shih KKPK dhe Raportin Shpjegues, <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/html/157.htm> (qasur më 24 tetor 2011).

⁸ Po aty, neni 6, KKPK.

⁹ Shih nenin 3(h) të Kornizës Kushtetuese të UNMIK-ut për Vetëqeverisje të Përkohshme, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9, të shpallur më 15 maj 2001 me ndryshimet pasuese; neni 22 i Kushtetutës së Kosovës, miratuar më 9 prill 2008, që hyri në fuqi më 15 qershor 2008; dhe neni 1 i Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, 13 mars 2008.

¹⁰ Po aty, neni 3, Ligji nr. 03/L-047.

¹¹ Shih ligjin nr. 03/L-040 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, 20 shkurt 2008, Kreu 3, “Kompetencat komunale”. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 20 shkurt 2008.

2016". Ajo ofron një kornizë të mirë dhe identifikon saktë fushat e intervenimit. Shumë aktivitete të përfshira janë të paqartë dhe duhet se ka më shumë objektiva sesa përshkrime të qarta të veprimeve që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse.¹²

Në nivel komunal, institucionet me përgjegjësi për mbrojtjen dhe promovimin e sigurisë së komuniteteve jo-shumicë gjenden kryesisht në degën ekzekutive. Kryetarët e Komunës janë kryesues të KKSBB-ve, i cili është organ i obligueshëm që përbën mekanizmin kryesor për këtë aspekt.¹³ Aktorë tjerë relevantë janë zëvendëskryetari i komunës për komunitete¹⁴, zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete¹⁵, komisioni për komunitete¹⁶ dhe zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)¹⁷. Ndonëse këto nuk kanë mandat eksplisit për trajtimin e çështjeve të sigurisë, ato luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e tolerancës ndërmjet komuniteteve dhe zbatimin e masave të ndërtimit të besimit, si dhe krijimin e një lidhjeje ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve tjera komunale.

Vlen të theksohet se incidentet e sigurisë mund të kenë ndikim negativ në perceptimin aktual apo të perceptuar të sigurisë dhe në disa raste mund të kufizojnë lirinë e lëvizjes dhe pengojnë qasjen e tyre në të drejtat dhe shërbimet themelore. Është me rëndësi që komunat të reagojnë në mënyrë efektive ndaj incidenteve të tilla. Kjo mund të bëhet përmes dialogut në forume përkatëse komunale të sigurisë, siç janë KKSBB-të, përmes dënimeve publike apo aktiviteteve të komunikimit, apo që të treve. Këto aktivitete mund të ndihmojnë që të kthehet besimi i komuniteteve të prekura të autoritetet për t'i trajtuar incidentet e rënda të sigurisë. Kjo mund të çojë në fuqizimin dhe promovimin e dialogut të komunitet, institucionet komunale dhe policia, si dhe përfundimisht mund të çojë në mbrojtjen nga incidentet e tilla të rënda në të ardhmen.

¹² Shih Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016, aprovuar nga qeveria e Kosovës në qershor 2011.

¹³ Shih shënimin 1, *më lartë*.

¹⁴ Në komunat ku së paku 10% e popullatës i përkasin komuniteteve joshumicë, pozita e zëvendëskryetarit të komunës për komunitete krijohet për ta ndihmuar, udhëzuar dhe këshilluar kryetarin e komunës për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë. Shih Ligjin për vetëqeverisje lokale, shënimi 12, *më lartë*, neni 61(1).

¹⁵ Në ato komuna ku së paku 10% të popullatës i përkasin komuniteteve joshumicë, themelohet pozita e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete. Mes detyrave tjera, kjo pozitë është përgjegjëse për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve. Shih Ligjin për vetëqeverisje lokale, shënimi 12, *më lartë*, nenet 54(1) dhe 55(1).

¹⁶ Komiteti për komunitete është mekanizëm i obligueshëm i ngarkuar për të promovuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve që banojnë në komuna, dhe përbëhet nga pjesëtarët e kuvendit komunal si dhe përfaqësues të komuniteteve. Shih Ligjin për vetëqeverisje lokale, shënimi 12, *më lartë*, nenet 51 dhe 53.

¹⁷ ZKKK është e mandatar për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, duke përfshirë ofrimin e qasjes së barabartë në shërbime publike dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar. Shih Rregulloren e Qeverisë nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

3. INCIDENTET E SIGURISË QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË NË KOSOVË – PASQYRË RAJONALE¹⁸

Siguria mbetet shqetësim kryesor për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Ndonëse krimi dhe dhuna prekin për të keq të gjitha komunitetet në Kosovë, incidentet e sigurisë mund të kenë ndikim të lartë në komunitetet joshumicë dhe gëzimin e tyre të drejtave të shumta themelore të njeriut.¹⁹ Incidentet e sigurisë rrisin cenueshmërinë reale dhe të perceptuar të viktimave dhe madje edhe të komunitetit përreth, dhe kjo shpeshherë përkeqësohet nëse viktimat janë pjesëtarë të komunitetit jo-shumicë që jetojnë në rajon të banuar në masë të madhe nga shumica. Për më tepër, perceptimet e komuniteteve jo-shumicë janë të lidhur ngushtë me aftësinë dhe gatishmërinë e tyre për të lëvizur lirshëm; nëse liria e lëvizjes komprometohet, kjo në anën tjetër rrezikon të drejtat tjera të njeriut, siç janë qasja në shërbime dhe punësim apo arsim, por edhe pjesëmarrjen në jetën publike. Incidentet e sigurisë kanë potencial që të nxisin tensione ndëretnike, si dhe të minojnë marrëdhëniet ndërmjet komunitetit jo-shumicë dhe institucioneve, posaçërisht nëse institucionet komunale nuk reagojnë në mënyrë efektive pasi që ato incidente të kenë ndodhur.

Kjo pjesë identifikon incidentet e rënda të sigurisë që prekin komunitetet jo-shumicë të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit në komuna të ndryshme në tërë Kosovën. Ajo paraqet hollësi të reagimeve komunale në shembujt më të rëndësishëm, si dhe hulumton reagimet e komuniteteve ndaj atyre reagimeve për të vlerësuar efektivitetin komunal në avancimin e sigurisë të perceptuar të komuniteteve jo-shumicë.

3.1. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, serbët e Kosovës, të cilët përbëjnë komunitetin e dytë më të madh në rajon, kanë raportuar numrin më të madh të incidenteve të sigurisë. Incidentet përfshinin sulme ndaj personave, pronës private dhe objekteve të rëndësishme kulturore dhe fetare. Më 18 shkurt 2010, varreza e serbit të parë kosovar që u varros në varrezën ortodokse serbe të Gjilanit që nga viti 1999 është përdhosur. Me kërkesë të familjes, kufoma është zhvarrosur dhe transferuar në një varrezë serbe ortodokse në një fshat të afërm me shumicë serbe. Kryetari i Gjilanit dënoi menjëherë incidentin përmes një komunikate për shtyp të publikuar në faqen e internetit të komunës; megjithatë, kjo komunikatë është lëshuar vetëm në gjuhën shqipe, duke e vështirësuar qasjen e komunitetit serb të Kosovës në të. Ky rast nxiti reagime edhe të akterëve të lartë të nivelit qendror: Kryeministri dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim vizituan varrezën më 21 shkurt 2010 dhe publikisht dënuan përdhosjen.²⁰

¹⁸ Kjo pjesë është ndarë në rajonet të cilat nuk janë rajone zyrtare të Kosovës por është ndarje organizative e OSBE-së e rajoneve gjatë periudhës së raportimit. Ndarjet e ndryshme organizative rajonale të OSBE-së janë Gjilan/Gnjilane; Mitrovicë/Mitrovica; Pejë/Peć; Prishtinë/Priština dhe Prizreni. Veç kësaj, secili rajon diskuton secilën komunë në baza individuale. Kjo qasje është shfrytëzuar për lexim më të lehtë.

¹⁹ Për informata të hollësishme demografike për të gjitha komunitetet në Kosovë, shih Raportin e OSBE-së *Profilet e Komuniteteve të Kosovës* (2010). <http://www.osce.org/kosovo/75450> (qasur më 3 dhjetor 2011).

²⁰ Për lexim të mëtejshëm të këtij incidenti ju lutem shihni Raportin e OSBE-së *Profilet e Komuniteteve të Kosovës* (2010), po aty.

Nuk kishte bërë asnjë komunikim i drejtpërdrejtë me familjen e prekur nga ana e institucioneve komunale. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës shprehën ndjenjat e tyre të drojës dhe përshkruan ndikimin negativ të incidentit në perceptimet e tyre të sigurisë. OSBE-ja ka intervistuar një pjesëtar të Bordit të Kishës Ortodokse në qytetin e Gjilanit/Gnjilane i cili përsëriti se institucionet komunale duhet të jenë më proaktive në trajtimin e paragjyqimit të komunitetit shumicë dhe t'i plotësojnë deklaratat publike të dënimeve të cilat, sipas të intervistuarve, perceptoheshin nga komuniteti i prekur si “reaktive dhe kryesisht simbolike për nga natyra”.²¹

Tri sulme të ndara ndaj serbëve të Kosovës janë bërë gjatë periudhës së raportimit në apo afër fshatit me shumicë serbe të Paralovo/Parallovës, që gjendet në komunën me shumicë serbe të Novo Brdo/Novobërdës. Më 15 mars 2010, një serb i Kosovës është raportuar i sulmuar pasi që është ndalur nga një grup i shqiptarëve të cilët e kishin bllokuar veturën e tij.²² Më 30 nëntor 2010, një shqiptar mashkull pohohet se ka sulmuar një serb gjatë një kontesti për një pronë. Më 28 dhjetor 2010, një serb pohohet se është sulmuar nga një shqiptar mashkull, po ashtu në lidhje me një kontest prone. Këta tre incidente kishin ndikim negativ në lirinë e lëvizjes së komunitetit serb të Kosovës, meqë shumë filluan t'iu shmangen kësaj zone ku kishin ndodhur sulmet. Gjersa institucionet komunale shumë shpejt kishin dënuar incidentin e parë përmes një komunikate publike të lëshuar për shtypin lokal në shqip dhe në serbisht më 18 mars 2010, asnjë deklaratë nuk është lëshuar për incidentin e dytë dhe të tretë. Veç kësaj, nuk është bërë asnjë komunikim me ta për t'i qetësuar viktimat dhe komunitetin e gjerë.

OSBE-ja ka intervistuar viktimën e sulmit të 30 nëntorit i cili tha se mungesa e një dënimi apo komunikimi me të nga ana e institucioneve komunale ishte për të ardhur keq dhe se ndikimi i masave të tilla në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve do të kishte qenë pozitiv. Viktima e incidentit të 28 dhjetorit 2010 po ashtu kishte shprehur zhgënjimin e tij se nuk është bërë asnjë deklaratë publike apo komunikim me të, ndonëse theksoi se kryetari i komunës e kishte thirrur liderin e fshatit pas incidentit për t'u interesuar lidhur me reagimin e komunitetit ndaj kësaj ngjarjeje. Në një intervistë tjetër, përfaqësuesi serb në fshatin Paralovo/Parallovë përsëriti rëndësinë e komunikimeve pas këtyre incidenteve, duke theksuar se vetëm dënimet nuk mund ta qetësojnë komunitetin e tij, pjesëtarët e të cilit ishin gjithnjë e më të shqetësuar për sigurinë e tyre, duke përfshirë lirinë e lëvizjes.²³

Në komunën e Ferizajt/Uroševac gjatë periudhës tetor dhe dhjetor 2010 janë bërë disa plaçkitje të vendbanimeve të të kthyerve. Sipas liderëve të komunitetit në këtë rajon, këto veprime të përsëritura kanë pasur ndikim negativ në perceptimin e sigurisë brenda komunitetit të vogël serb, duke e rënduar qëndrueshmërinë e kthimit të tyre. Më 8 tetor 2010, një shtëpi e pabanuar është shënjestruar në fshatin Bablak/Babljak dhe pronari e ka raportuar incidentin në polici. Më 26 tetor 2010, katër shtëpi të pabanuara prona të serbëve të Kosovës janë plaçkitur me thyerje në fshatin Srpski Babuš/Babush i Serbëve. Në po këtë fshat, një shtëpi është thyer më 29 nëntor 2010. Një tjetër serb i Kosovës ka raportuar në polici se më 2 dhjetor 2010 shtëpia e tij Babljak/Bablak është grabitur. Në të gjitha rastet mungonin pajisje shtëpiake. Ndonëse policia kishte nisur hetimet, ata

²¹ Serb i Kosovës, anëtar i Bordit të Kishës Ortodokse, komuna e Gjilanit/Gnjilane, intervistë personale, 14 janar 2011.

²² Shih shënimin 20, sipër

²³ Viktimat e sulmeve të 30 nëntorit dhe 28 dhjetorit 2010 në Paralovo/Parallovë dhe përfaqësuesi serb i komunitetit në Paralovo/Parallovë, intervistë personale, 11 janar 2011.

deri më tani nuk kanë arrestuar asnjë të dyshuar. Institucionet komunale nuk kanë bërë asnjë dënim apo komunikim sensibilizues.

OSBE-ja ka intervistuar një përfaqësues të komunitetit i cili kishte kontaktuar me kryetarin e komunës pas incidentit, por që atij i ishte thënë se komunikimi sensibilizues është detyrë e policisë.²⁴ Përfaqësuesi serb në KKSB-në në Ferizaj/Uroševac theksoi plaçkitjet kishin arritur ndikim negativ në kthimet e mundshme në këtë rajon. Përkundër motivimit të dukshëm material prapa krimeve, ai insistonte se përkatësia etnike e viktimave i bënte shtëpitë “caqe të lehta” dhe dënimi dhe komunikimi nga ana e zyrtarëve komunalë do të ishte mirëpritur nga ana e komunitetit.²⁵ Vlen të theksohet se përdërisa incidentet e rënda të sigurisë kanë vazhduar më 2011, OSBE-ja ka vërejtur se komuna ka filluar të ndërmerr hapa të rëndësishëm në reagimet ndaj këtyre incidenteve.

Kisha Ortodokse Serbe në Fshatin Donja Budriga/Budrikë e Poshtme në komunën e re të Parteš/Parteshit është plaçkitur me thyerje më 2 dhjetor 2010 është hequr bakri nga struktura e ndërtesës. Ky ishte incidenti i dytë, pas një plaçkitjeje të mëhershme më 6 nëntor 2009. Përkundër faktit se të dy rastet janë raportuar menjëherë në polici dhe se kisha në fjalë ishte përfshirë në një plan rajonal operativ të policisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore²⁶, komuniteti mendonte se policia megjithatë nuk ishte në gjendje t’i parandalojë plaçkitjet e përsëritura për shkak të mosarritjes së patrullimeve. OSBE-ja ka kontaktuar me një prift ortodoks serb i cili shprehu drojë për mungesën e një reagimi komunal ndaj incidenteve, posaçërisht mungesën e dënimeve dhe komunikimit me komunitetin.

Komunitetet tjera po ashtu ishin të prekura nga incidentet e sigurisë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane në vitin 2010. Ashkalitë e Kosovës, të cilët kryesisht banojnë në komunën e Ferizajt/Uroševac, vazhdojnë të preken nga incidentet e sigurisë. Për shembull, më 23 janar 2010, një i ashkali i mitur nga lagja Sallahane në qytetin Ferizaj/Uroševac ishte therur me thikë²⁷. Ndonëse incidenti është diskutuar në takimin e KKSB-së në Ferizaj/Uroševac më 2 mars 2010, liderët e komunitetit të kontaktuar nga OSBE-ja shfaqnin ngurrim që të flasin haptas për therjen; vetë komuniteti kishte tenenë të minimizimit të rëndësisë së sulmit.²⁸

Megjithatë, zëvendëskryetari i komunës për komunitete, një përfaqësues ashkali i Kosovës i cili është emëruar pas incidentit, shprehte keqardhje për mungesën e dënimit apo komunikimeve sensibilizuese pas incidenteve nga ana e komunës. Në anën tjetër, një zyrtar nga ZKKK theksoi se ndikimi i kufizuar i incidentit në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve nuk garantonte dënim nga ana e komunës. Zyrtari i intervistuar mendonte se vizita sensibilizuese nga kreu i ZKKK-së pas incidentit nuk mjaftonte. Gjithashtu, ai theksoi se duhet të ndahen fonde specifike për sensibilizim nga ana e komunës dhe asistencë pas incidenteve të konsiderueshme të sigurisë.²⁹

²⁴ Banor serb i fshatit Talinoc/Tallinovac, komuna e Ferizajt/Uroševac, intervistë personale, intervistë në shtëpinë e tij më 19 janar 2011.

²⁵ Përfaqësues serb i Kosovës në KKSB-në në Ferizaj/Uroševac, komuna e Ferizajt, intervistë personale, 19 janar 2011.

²⁶ Prift serb ortodoks në Kosovë në fshatin Donja Budriga/Budrikë e Poshtme, qyteti i Parteš/Parteshit, intervistë personale, 17 janar 2011.

²⁷ Përfaqësuesi ashkali në cilësi të Zëvendëskryetarit të Komunës për Komunitete, 28 dhjetor 2010.

²⁸ Po aty.

²⁹ Zyra komunale, ZKKK në komunën e Ferizajt/Uroševac, intervistë personale, 28 dhjetor 2010.

Gjithashtu, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti i vogël dhe kryesisht i moshuar i kroatëve të Kosovës në komunën e Vitisë vazhdoi të përjetojë ngacmime të vazhdueshme verbale dhe fizike si dhe kërcënime nga ana e shqiptarëve kosovarë fqinj dhe shqiptarëve etnikë të IRJM-së, të cilët kanë uzurpuar shumicën e shtëpive të zbrazëta të kroatëve të Kosovës në atë rajon.³⁰ Gjatë takimit të KKSBB-së, edhe Kryetari i komunës edhe komandanti i stacionit policor kanë vlerësuar gjendjen e sigurisë në Viti/Vitina si të qetë, pa ndonjë incident të raportuar në lidhje me komunitetet jo-shumicë. Përfaqësuesit e komuniteteve, të konsultuar nga OSBE-ja, pas sulmit, kanë shprehur brengat e tyre në lidhje me raportimin e incidenteve në polici, për shkak të frikës së hakmarrjes, si dhe kanë konfirmuar që liria e tyre e lëvizjes ka vazhduar të kufizohet.

3.2. Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Siguria e komuniteteve jo-shumicë në Mitrovicë/Mitrovica më 2010 ka reflektuar përkeqësimin e përgjithshëm të gjendjes së sigurisë në komunat veriore të rajonit, me një numër të rritur të incidenteve të sigurisë mes komuniteteve, mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, që të dyja palët të pretenduara si kryes dhe si viktimë. Incidente të tilla janë raportuar tek Tre Rrokaqiejt/Tri Solitera, Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, Suhodoll/Suvi Do (i epërm dhe i poshtëm) si dhe Lagja e Doktorëve/Dolina Doktora, Mahalla e Boshnjakëve, si dhe zona afër urës kryesore mbi lumin Ibër/Ibar. Në këto zona, sulmet nga grupet e serbëve kundër shqiptarëve kanë qenë të shpeshta, si dhe kanë shkuar prej grafiteve ofenduese e abuzimeve verbale, e deri tek gjuajtja me gurë ndaj personave dhe/ose veturave, sulmeve, të shtënave të kohëpaskohshme, dhe/ose mjetet eksplozive që janë vendosur në prona private. Arrestimet kanë qenë të rralla, derisa incidentet hakmarrëse shpesh kanë ngjarë, duke çuar dyja komunitetet në një cikël dhune, të cilin policia duket të mos ketë qenë në gjendje ta ndalojë.

Një incident më domethënës ngjau më 9 qershor 2010, kur një grup të rinjsh serbë pretendohet të ketë sulmuar një grup tjetër të rinjsh shqiptarë në fushëlojën lokale tek lagjia e “Tre Rrokaqiejve”, një zonë e përzier me komunitete, duke çuar kështu në hospitalizimin e pesë shqiptarëve të lënduar. Edhe shqiptarët edhe serbët që banojnë në Mikronaselje/Kodra e Minatorëve dhe “Tre Rrokaqiejt” kanë dënuar sulmin, si dhe kanë kërkuar prani të rritur policore, e cila është siguruar. Megjithatë, më 10 qershor 2010, një grup të rinjsh shqiptarë janë raportuar të kenë sulmuar tre meshkuj serbë, në një sulm që dukej të jetë si sulm hakmarrës. Institucionet komunale të vendosura në Mitrovicën/Mitrovica jugore kanë dënuar dhunën, si dhe janë takuar me udhëheqësit shqiptarë në pjesën veriore të qytetit. Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (UAM), e cila aktualisht është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve komunale për Mitrovica/Mitrovicën veriore nuk ka lëshuar ndonjë deklaratë e as kanë bërë ndonjë aktivitet vetëdijesues në vazhdimësi. Një prej të rinjve shqiptarë të sulmuar në incidentin e 9 qershorit 2010, ka theksuar që nuk ka qenë i kënaqur me përgjigjen e komunës së Mitrovicës/Mitrovica. Ai ishte i mendimit që komuna kishte bërë shumë pak për të ndihmuar viktimat, familjet e tyre dhe komunitetin pas incidentit. Ai

³⁰ Raporti i OSBE-së Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë: Komunitet i Cenueshëm <http://www.osce.org/kosovo/83789>

shtonte që kjo ishte në kundërshtim me përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, si dhe fqinjëve të tij serbë që i kishin ofruar viktimave shqiptare shumë përkrahje.³¹

Komuniteti boshnjak i Kosovës kohë pas kohe preket nga tensionet dhe aktet e shpeshta të dhunës në veri të Kosovës.³² Pas këtyre rasteve, komuniteti boshnjak i Kosovës nuk ka qenë i kënaqur me reagimin e komunës. Veç kësaj, komuniteti ka shprehur keqardhje që nuk ka pasur vëmendje më të madhe ndaj incidenteve që përfshijnë shqiptarët dhe serbët. Një rast shumë më i spikatur ishte vrasja e një boshnjaku gjatë një demonstrate të 2 korrikut 2010 kundër hapjes së qendrës së regjistrimit civil nga institucionet e Kosovës, kur një granatë e dorës është hedhur mbi turmë. Incidenti është dënua edhe nga komiteti komunal për siguri publike i Mitrovicës/Mitrovica³³, i cili ka mbajtur një takim të jashtëzakonshëm të njëjtën ditë, dhe strukturat komunale të udhëhequra nga Serbia në Mitrovicën veriore. Megjithatë, një përfaqësues i boshnjakëve nga lagjja kishte shprehur keqardhjen që deklaratat publike të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës ishin të një natyre tejet politike, si dhe që nuk ishte bërë asnjë aktivitet me komunitetin.³⁴

Perceptimet e sigurisë nga ana e shqiptarëve që jetojnë në komunat me shumicë serbe të Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviqit dhe Zvečan/Zveçanit është prekur kur shërbimi i autobusëve humanitarë³⁵ është raportuar të jetë gjuajtur me gurë më 14 maj 2010, e pastaj prapë më 10 qershor 2010. Shërbimi transporton shqiptarët nga Koshtova/Košutovo, Bistrica/Bistrica dhe Ceraja/Ceranje në komunën e Leposavić/Leposaviqit në Mitrovicën/Mitrovica e jugut. Sipas përfaqësuesve të komuniteteve, hedhja e gurëve ndodh shpesh, por jo gjithmonë i raportohet policisë.

Incidenti më i spikatur i sigurisë në këto komuna ka qenë shënjestrimi i përsëritur i një furre buke që mbahet nga një shqiptar në qytetin e Zvečan/Zveçanit. Në gjysmën e dytë të vitit 2010, lokali i tij është shënjestruar tetë herë, duke përfshirë një rast kur dy sulmues kanë sulmuar fizikisht pronarin. Në atë rast, sulmuesit, pohohet të kenë qenë serbë, kanë hyrë në furrë, i kanë thënë pronarit të gjuajë cigaren, si dhe i kanë kërkuar të theksojë shkronjën “Ć” në serbisht. Kur ai ka bërë këtë, i kanë thënë që nuk është theksuar mirë dhe e kanë sulmuar. Strukturat komunale në komunën e Zvečan/Zveçanit, të cilat mbështeten nga Republika e Serbisë, kanë dënua publikisht gjitha këto incidente, por nuk kanë bërë ndonjë aktivitet përafrimi me viktimën. Kur është

³¹ I ri shqiptar i shënjestruar në incidentin e 9 qershorit 2010, Qendra Rajonale e OSBE-së në Mitrovicë/Mitrovica, intervistë personale, 25 janar 2011.

³² Për shembull më 17 janar 2010, një mashkull boshnjak është pohuar të jetë kërcënuar dhe ofenduar nga një serb në lidhje me një kontest pronësor. Më 9 prill 2010, një femër boshnjake është thënë të jetë ngacmuar nga një femër shqiptare, e cila ka kërcënuar ta vrasë atë dhe djalën e saj nëse nuk braktis Mitrovica/Mitrovicën e veriut. Më 14 maj 2010, një mashkull boshnjak ka raportuar kërcënimet nga një serb kundrejt familjes së tij. Më 4 qershor 2010, një femër boshnjake ka raportuar që është kërcënuar nga një mashkull shqiptar në një përpjekje për ta detyruar atë të nënshkruajë për një pronë të saj në Mitrovica/Mitrovicën e veriut.

³³ Më 11 shkurt 2008, komuna e Mitrovicës/Mitrovica ka themeluar një “komitet për mbrojtje dhe shpëtim”, me qëllim të shqyrtimit dhe monitorimit të afërt të gjendjes së përgjithshme të sigurisë dhe asaj politike në Komunë. Ai tanimë ka ndërruar emrin dhe është bërë “komiteti komunal për siguri publike”, me të cilin vazhdon të kryejë detyra të ngjashme.

³⁴ Përfaqësues boshnjak i Mëhallës së Boshnjakëve, intervistë personale, 18 janar 2011.

³⁵ Shërbimet e transportit humanitar me autobus funksionojnë në gjithë Kosovën, duke ndërlidhur zonat e banuara me komunitete jo-shumicë. Shërbimi, fillimisht i themeluar nga UNHCR-ja, është administruar nga UNMIK-u deri më 2007, kur është bartur tek Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit e Kosovës.

intervistuar nga OSBE-ja, viktimat ka sinjalizuar qëllimin e tij të braktisë Zvečan/Zveçanin për shkak të brengave të vazhdueshme për sigurinë dhe për shkak të mungesës së përkrahjes komunale dhe përafrimit me to.³⁶

Në komunat në jug të Lumit Ibër, kanë dominuar incidente që shënjestrojnë pronat e serbëve të Kosovës. Për shembull, plaçkitjet dhe uzurpimet e tokave, kryesisht të pronave të pabanuara të të kthyerve, janë raportuar në Svinjarë/Svinjare, komunën e Mitrovicës/Mitrovica, mes janarit dhe shkurtit 2010, derisa disa incidente janë raportuar në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn në mars të vitit 2010.³⁷ Në gjitha rastet, komunat përkatëse nuk kanë dënuar incidentet, as publikisht e as gjatë takimeve komunale, e as nuk kanë bërë ndonjë aktivitet për afrim me viktimat.

Përfaqësuesi i fshatit të banuar me serbë të Gojbulja/Gojbulës në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn ka shprehur frustrimin e tij për mungesën e reagimit të komunës ndaj incidenteve të sigurisë.³⁸ Më 17 shkurt 2010, një autobus i shërbimit humanitar që po udhëtonte nga fshati Osojan/Osojane në komunën e Istogut/Istok, rajoni i Pejës/Peć, drejt Mitrovica/Mitrovicës së veriut, që bartte rreth 50 serbë të Kosovës është gjuajtur me gurë nga fëmijët e shkollave derisa po kalonte përmes fshatit të banuar me shqiptarë të Runikut/Rudnik në komunën e Skenderajt/Srbica. Si reagim, njësisia e policisë në komunitet e Skenderajt/Srbica³⁹ ka rritur numrin e patrullimeve në zonë, si dhe ka organizuar takime me drejtorin e shkollës lokale, disa nga mësimdhënësit, nxënësit dhe këshillin e prindërve.⁴⁰ Megjithatë, nuk janë lëshuar deklarata publike nga komuna e Istogut/Istok (prej nga vinin serbët) e as nga komuna e Skenderajt/Srbica. Përveç kësaj, serbi në krye të zyrës komunale për komunitete të Skenderajt/Srbica⁴¹ ka shprehur keqardhjen për mungesën e përafrimit me komunitetin e prekur.⁴²

3.3. Rajoni i Pejës/Peć

Në rajonin e Pejës/Peć – ku serbët përbëjnë komunitetin e katërt më të madh – sulmet kundër tyre dhe pronës së tyre janë rritur në fillim të vitit 2010, me ndikim negativ mbi perceptimin e tyre për sigurinë dhe rendin.⁴³ Mes janarit dhe marsit 2010, një

³⁶ Pronar shqiptar i furrës në qytetin e Zvečan/Zveçanit, lokalet e OSBE-së në Mitrovicën/Mitrovica e jugut, intervistë personale, 16 dhjetor 2010 dhe 25 janar 2011.

³⁷ Më 8 mars 2010, janë plaçkitur shtëpitë e të kthyerve serbë në fshatin Maxhunaj/Novo Selo, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn; më 18 mars 2010, dritaret e një objekti në lokalet e kishës ortodokse të Shën Elias në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn janë dëmtuar; më 26 mars 2010, serbët e Kosovës banorë të fshatit Gojbulja/Gojbulë kanë raportuar vjedhjen e pajisjeve bujqësore dhe ngacmimet nga një numër të rinjsh shqiptarë nga një fshat fqinj.

³⁸ Përfaqësuesi i serbëve në fshatin Gojbulja/Gojbulë, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, intervistë telefonike, 21 janar 2011.

³⁹ Njësitë e policisë në komunitet më parë kanë qenë njësi brenda Policisë së Kosovës, me orientim të veçantë kah çështjet e sigurisë së komuniteteve. Megjithatë, ato janë shpërbërë në pranverën e vitit 2010, derisa detyrat e tyre janë bartur tek oficerët tjerë të policisë së Kosovës.

⁴⁰ Shih shënimin 20, sipër.

⁴¹ Zyra Komunale e Komuniteteve (ZKK) është përgjegjëse për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për sigurimin e qasjes së barabartë të komuniteteve ndaj shërbimeve publike në nivel të komunës. Rregullorja e Qeverisë nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim ka bashkuar zyrat komunale për komunitete me zyrat komunale për kthim.

⁴² Udhëheqësi serb i ZKK-së së Skenderajt/Srbica, fshati Banja/Bajë, intervistë personale në lokalet e ZKK-së, 12 janar 2011.

⁴³ Incidente të konsiderueshme numërohen edhe shqyerja e përsëritur e gomave të veturave të serbëve në fshatin Videjë/Vidanje, komuna e Klinës/Klina, mes janarit dhe marsit 2010. Gjatë së njëjtës periudhë, kanë ndodhur plaçkitje të shpeshta të pronave të braktitura të serbëve të zhvendosur në

shtëpi në qytetin e Klinës/Klina, pronë e një çifti të moshuar serbësh të kthyer është gjuajtur me gurë vazhdimisht për tri ditë me radhë. Më 24 shkurt 2010, Zëvendës Kryeministri dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim është takuar me Kryetarin e komunës së Klinës/Klina, duke lëshuar një deklaratë të përbashkët publike për dënimin e incidenteve. Delegacioni pastaj ka kryer një vizitë tek familja, derisa komuna më vonë ka financuar gjithë punët në riparim. Njësia e policisë në komunitet ka kryer vizitat dhe është afruar me familjen e shënjestruar. Kur është intervistuar nga OSBE-ja, viktimja ka lënduar reagimin e institucioneve komunale, si dhe ka shtuar që jo vetëm që siguron familjen e tij, por edhe komunitetin në përgjithësi. Një serb i punësuar nga komuna gjithashtu ka lënduar reagimin komunal ndaj këtij dhe incidenteve tjera të sigurisë që prekin komunitetin e tij, të cilat ai beson të kenë kontribuar pozitivisht në përmirësimin e marrëdhënieve mes komuniteteve në Klinë/Klina.⁴⁴

Përgjatë vitit 2010, incidentet e sigurisë me shënjestrim tek të kthyerit serbë të Kosovës janë raportuar shpesh në fshatin e përzier etnik të Zallqit/Žac në komunën e Istogut/Istok.⁴⁵ Më 17 gusht, një shtëpi e të kthyerve në ndërtim e sipër ishte dëmtuar, derisa më 18 gusht, është vënë zjarr në një fushë me bar afër tendave të të kthyerve. Incidenti më i spikatur ka ngjarë më 20 shkurt 2010, kur një i kthyer serb është sulmuar derisa po ecte nga Zallqi/Žac drejt fshatit të banuar me serbë të Osojane/Osojanit, Komuna e Istogut/Istok, duke i shkaktuar kështu lëndime trupore. Zyrtarët komunalë kanë lëshuar dy deklarata publike të dënimit të këtyre akteve. E para është bërë nga udhëheqësja serbe e nën-zyrës komunale të komuniteteve në Osojane/Osojan, duke dhënë disa intervista për mediat serbe dhe duke dënuar sulmin. Ajo shtonte që incidenti kishte nxitur reagime negative të komunitetit serb, si dhe që kjo gjë mund të ndikojë negativisht procesin e vazhdueshëm të kthimit në komunë. Deklarata e dytë është bërë nga zyrtari komunal egjiptian i kthimit, i cili kishte vizituar të kthyerit serbë në fshatin Zallq/Žac, si dhe kishte dënuar po ashtu sulmin.

Ngjarjet në Zallq/Žac gjatë gjithë vitit 2010 kanë tërhequr vëmendjen e zyrtarëve qendrorë dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët kanë dënuar incidentet në mediat lokale në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Zëvendëskryetari i Komunës për Komunitete ka lëshuar një deklaratë shtypi, duke dënuar fuqimisht incidentet që kanë ngjarë në gushtin e vitit 2010. Komiteti për komunitete i Istogut/Istok është mbledhur më 25 gusht 2010, duke dënuar incidentet përmes një deklarate publike, derisa më 2 shtator 2010, Kryetari i Komunës dhe komandanti i policisë në Istog/Istok vizituan të kthyerit serbë dhe komunitetin pranues për të promovuar dialogun. Përfaqësuesi i serbëve në Zallq/Žac lëndoi deklaratat publike dhe vizitat afruese të bëra nga zyrtarët komunalë, duke shtuar

fshatin Belo Polje/Bellopojë afër qytetit të Pejës/Peć, duke mos shkaktuar reagime komunale. Një shtëpi e zbrazur në fshatin e serbëve të kthyer të Gremnikut/Grebnik, komuna Klinë/Klina, është vënë në zjarr. Në maj të vitit 2010, një autobus i vozitur nga serbë është gjuajtur me gurë në fshatin Shtupel/Štupelj, Komuna e Klinës/Klina. Në qershor të vitit 2010, tri shtëpi të serbëve janë plaçkitur në fshatin Berkovë/Berkovo, gjithashtu në komunën e Klinës/Klina.

⁴⁴ Pronari serb i shtëpisë së gjuajtur me gurë në Klinë/Klina, si dhe punëtori serb i komunës së Klinës/Klina, intervista personale në shtëpitë e tyre përkatëse, 5 janar 2011.

⁴⁵ Mes 19 prillit dhe 23 gushtit 2010, janë raportuar trembëdhjetë incidente të ndara tek policia, duke përfshirë gjuajtjen me gurë ndaj një serbi, gjuajtjen me gurë ndaj tendave të përkohshme për të kthyerit, dëmtimi i objekteve të banimit të të kthyerve në ndërtim e sipër, një djegie e pohuar e fushës me bar që është rreth 200–300 metra larg tendave të komunitetit të kthyer jo-shumicë, si dhe të shtënat me armë në afërsi.

që këto kanë ndikim pozitiv në perceptimet e sigurisë tek të kthyerit.⁴⁶ Për më tepër, viktimat e sulmit të 20 shkurtit 2010 është vizituar vetëm nga zyrtarët serbë të komunës që punojnë në ZKKK, gjë që në këndvështrimin e tij zvogëlon ndikimin pozitiv të atyre vizitave.⁴⁷

Edhe komunitetet tjera⁴⁸ janë prekur nga incidentet e sigurisë në rajonin e Pejës/Peć më 2010, sidomos boshnjakët e Kosovës.⁴⁹ Edhe pse shumë nga incidentet që kanë shënjestruar boshnjakët kanë rezultuar në arrestim të autorëve të pohuar, në shumicën e rasteve nuk ka pasur dënim të incidenteve, e as aktivitete të mëtutjeshme nga komunat. Një përjashtim ka pasur incidentin më serioz, i cili ka ngjarë më 26 tetor 2010 në fshatin Zllapek/Zlopek, komuna Pejë/Peć, kur një mashkull boshnjak është sulmuar në oborrin e tij nga katër shqiptarë. Kryetari i komunës së Pejës/Peć ka dënuar incidentin, si dhe ka vizituar viktimën dhe familjen e tij, i përcjellur nga Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Pakica, si dhe zyrtarë të tjerë komunalë; megjithatë, incidenti asnjëherë nuk është diskutuar gjatë mbledhjeve të KKS-së. Në një intervistë me OSBE-në, viktimat ka theksuar që vizitat nga komuna janë parë si tejet pozitive, jo vetëm nga ai por edhe nga i gjithë komuniteti boshnjak i zonës.⁵⁰ Megjithatë, përkundër këtyre, si dhe përpjekjeve të policisë, ai ka vendosur të ikë nga fshati përgjithmonë në janar të vitit 2011, për shkak të brengave të vazhdueshme të sigurisë së tij.

3.4. Rajoni i Prishtinës/Priština

Në rajonin e Prishtinës/Priština, incidentet e sigurisë me shënjestrim të serbëve të Kosovës – të cilët përbëjnë komunitetin e dytë më të madh – vazhduan të ndodhin, duke dëmtuar kështu sigurinë e komunitetit. Serbët, pronat e tyre private, si dhe objektet me rëndësi kulturore e fetare, janë shënjestruar përgjatë gjithë vitit 2010.⁵¹

⁴⁶ Përfaqësues i serbëve, intervistë personale në shtëpinë e tij të sapo-ndërtuar në fshatin Zallq/Žač, 10 janar 2011.

⁴⁷ Viktimë serbe e sulmit të 20 shkurtit 2010, intervistë personale në shtëpinë e tij në fshatin Zallq/Žač, 10 janar 2011.

⁴⁸ Dy sulme kundër egjiptasve janë raportuar në qytetin e Pejës/Peć dhe atë të Gjakovës/Đakovica më 1 mars, respektivisht më 8 maj 2010; dy meshkuj egjiptas janë sulmuar në fshatin Novosellë/Novo Selo në komunën e Pejës/Peć; një rom është sulmuar më 26 shkurt 2010 në qytetin e Pejës/Peć.

⁴⁹ Më 14 janar 2010, janë dërguar mesazhe tekstuale kërcënuese nga një person i panjohur tek një mashkull boshnjak në qytetin e Pejës/Peć; më 1 mars 2010, një mashkull tjetër boshnjak është sulmuar dhe plaçkitur në qytetin e Pejës/Peć, pohohet nga një shqiptar, i cili më vonë është ndaluar dhe është marrë në pyetje nga policia e Kosovës; më 22 mars 2010, një studente boshnjake e shkollës së mesme teknike në Pejë/Peć është sulmuar, pohohet nga dy nxënës shqiptarë të së njëjtës shkollë, të cilët janë marrë në pyetje më vonë nga policia; më 26 prill 2010 një mashkull boshnjak është sulmuar në qytetin e Pejës/Peć, gjoja nga një grup shqiptarësh; më 15 maj 2010, një grup meshkujsh shqiptarë janë arrestuar në veprën e sulmimit të një mashkulli boshnjak në qytetin e Gjakovës/Đakovica; më 1 korrik 2010, shtëpia e një boshnjaku është vënë në zjarr në fshatin Vitimiricë/Vitomirica, komuna e Pejës/Peć.

⁵⁰ Boshnjaku i sulmuar më 26 tetor 2010 në fshatin Zllapek/Zlopek, intervistë personale në shtëpinë e tij, 29 dhjetor 2010.

⁵¹ Për shembull, më 11 mars 2010, një mashkull i moshuar serb është sulmuar dhe plaçkitur në fshatin e përzier etnikisht të Čaglavica/Čaglavicës, komuna Gračanica/Gračanicë, pa ndonjë reagim apo aktivitet pasues nga komuna; më 23 prill 2010 shtëpia dhe dritaret e automjetit të një familjeje serbe në fshatin Kishnicë/Kišnica, komuna Gračanica/Gračanicë, janë gjuajtur me gurë, pa ndonjë reagim nga institucionet komunale; më 14 gusht 2010, një shtëpi serbe është shënjestruar me një mjet eksplozues në fshatin Donja Budriga/Budrikë e Poshtme, komuna Prishtinë/Priština; më 25 nëntor 2010 në fshatin Metergoc/Medregovac, komuna Podujevë/Podujevo, një grua e moshuar serbe është

Mes dhjetorit 2009 dhe janarit 2010, varreza ortodokse serbe në fshatin Lismir/Dobri Dub, komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje, është dëmtuar, të cilët mbesin në liri. Incidenti është diskutuar gjatë një mbledhjeje komunale, në të cilën kryesuesi i kuvendit të komunës ka shprehur keqardhjen e tij për incidentin. Megjithatë, nuk është lëshuar ndonjë deklaratë publike, e as është bërë ndonjë aktivitet pasues. Një varrezë tjetër ortodokse serbe është përdhosur më 21 tetor 2010 në qendren e qytetit të Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Katër ditë më vonë, zyrtarët komunalë vizituan vendin, si dhe vlerësimi i tyre fillestar ishte që dëmi ishte shkaktuar nga bagëtia. Megjithatë, janë vërejtur edhe gjurmë këmbësh përreth gurëve të dëmtuar të varreve, derisa porta e varrezës ishte vjedhur gjatë të njëjtit incident.⁵² Asnjëherë nuk është bërë dënimi publik, e as vizita pasuese, nga komuna. Prifti lokal ortodoks serb ka bartur frustrimin e komunitetit, duke theksuar që një vlerësim i tillë fillestar nga komuna ka përforcuar ndikimin negativ të incidentit mbi perceptimin e sigurisë në komunitet.⁵³

Më 15 janar 2010, janë dëmtuar njëzet gurë varresh në varrezën ortodokse serbe në fshatin Laplje Selo/Llapllasellë, komuna Gračanica/Gračanicë. Prifti ortodoks serb, i intervistuar nga OSBE-ja, ka lëvdur punën e policisë në hetim të rastit.⁵⁴ Megjithatë, nuk ka pasur as dënim të incidentit nga komuna, e as aktivitete pasuese në komunitet, derisa dëmi është riparuar nga familjet e të varrosurve. Një varrezë tjetër ortodokse serbe është përdhosur më 30 mars 2010 në fshatin e përzier etnikisht të Rubovcit/Rubovce në komunën e Lipjanit/Lipljan, një akt që është dënuar publikisht nga Presidenti i Kosovës dhe Kryeministri. Edhe Kryetari i komunës ka dënuar incidentin përmes një deklaratë të shtypit për mediat lokale, derisa komuna përfundimisht ka financuar riparimin e gurëve të dëmtuar të varreve.⁵⁵ Përfaqësuesi serb nga Rubovci/Rubovce ka shprehur keqardhjen për vonesën në riparimin e dëmeve, por ka lëvdur dënimin e menjëhershëm si dhe aktivitetet pasuese gjithëpërfshirëse nga Kryetari i Komunës si dhe ZKKK-ja.⁵⁶ Përfundimisht, kisha ortodokse serbe “Shën Andrea” në qytetin e Podujevës/Podujevo, rajoni Prishtinë/Priština, është dëmtuar më 27 qershor 2010, kur janë hedhur vajra mbi muret e saj të jashtme.⁵⁷ Edhe pse zyrtarët e atjeshëm komunalë nuk kanë dënuar publikisht incidentin, apo nuk ka pasur aktivitete përafrimi me komunitetin, në nëntorin e vitit 2010, kisha është riparuar me fondet e komunës.

Një sërë incidentesh me shënjestër shtëpitë e ashkalijve të Kosovës (komuniteti i tretë më i madh në rajon) janë raportuar në fshatin Nakaradë/Nakarade në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje më 3 dhe 26 mars, si dhe më 10 prill 2010. Dritaret e

sulmuar, pohohet nga shqiptarë, kur ka provuar të ndalojë prerjen e paligjshme të druve në afërsi të shtëpisë së familjes së saj.

⁵² Lokacioni i vizituar nga OSBE-ja pas incidentit.

⁵³ Prift ortodoks serb, fshati Lismir/Dobri Dub, komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje, intervistë telefonike, 13 janar 2011.

⁵⁴ Prifti ortodoks serb i fshatit Laplje Selo/Llapllasellë, komuna Gračanica/Gračanicë, intervistë personale në shtëpinë e tij, 24 janar 2011.

⁵⁵ Është themeluar një komision për vlerësimin e dëmit shpejt pasi ka ndodhur incidenti, por që nuk është mbledhur asnjëherë. OSBE-ja ka kontaktuar dy herë me Kryetarin e komunës në lidhje me riparimet, të cilat përfundimisht janë bërë në nëntor 2010.

⁵⁶ Përfaqësuesi serb nga fshati Rubovc/Rubovce, intervistë personale në qytetin e Lipjanit/Lipljan, 21 janar 2011.

⁵⁷ Kjo kishë është dëmtuar rëndë gjatë trazirave të vitit 2004, derisa më vonë është riparuar plotësisht nga Komisioni për Implementimin e Rindërtimit më 2008. Megjithatë, janë bërë edhe riparime tjera pas vandalizimit në qershor të vitit 2010, nga komuna, nga linja buxhetore e mallrave dhe shërbimeve.

katër shtëpive të të kthyerve janë dëmtuar gjatë dhe pas rindërtimit të tyre, derisa familjet gjithashtu kanë raportuar për përvojat e frikësimit dhe presionit nga fqinjët e tyre shqiptarë, për të shitur pronat e tyre me çmime të ulëta. Këto incidente nuk janë dënuar me deklarata publike, e as aktivitete përafrimi nga zyrtarët komunalë. Edhe pse dritaret e thyera janë ndërruar nga komuna pas incidentit të parë, një veprim i tillë nuk është kryer pas të dytit apo të tretit. Incidentet janë diskutuar në KKSBB gjatë takimit të tij të 23 prillit 2010, nga përfaqësuesi i ashkalijve, i cili ka shprehur kënaqësinë e tij me reagimin e komunës. Sipas tij, incidentet nuk kanë pasur ndonjë ndikim të dallueshëm në perceptimet e komunitetit për sigurinë. Megjithatë, duhet theksuar që përfundimisht, dy nga katër familjet kanë shitur shtëpitë e tyre, si dhe janë zhvendosur nga zona.⁵⁸

3.5. Rajoni i Prizrenit

Rajoni i Prizrenit ka përjetuar numrin më të vogël të incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet jo-shumicë në Kosovë, edhe pse janë raportuar disa sulme më 2010. Incidenti më i spikatur ka shënjestruar pronën private të serbëve dhe objektet e rëndësishme fetare. Më 28 janar 2010, persona të panjohur kanë dëmtuar dyert dhe dritaret e një qendre shëndetësore, shkolle dhe shtëpie në fshatin e serbëve të kthyer, Novake/Novak, komuna Prizren. Katër të rinj shqiptarë janë ndaluar në lidhje me rastin, derisa të gjithë këta i janë afruar kryetarit të fshatit, bashkë me prindërit e tyre, për të kërkuar falje për incidentin. Në shkurt të vitit 2010, shtëpia e një serbi është dëmtuar në qytetin e Rahovecit/Orahovac. Diku mes 13 dhe 16 prillit 2010, është vjedhur kambana e kishës nga kisha ortodokse serbe “Sveti Vrač” në rrethinën e fshatit të banuar me serbë, Novake/Novak, komuna Prizren. Komuna nuk ka lëshuar ndonjë deklaratë publike të dënimit në lidhje me këto ngjarje, e as ka ndërmarrë ndonjë aktivitet përafrimi.⁵⁹

Zjarre të shkaktuara nga shkaqe të panjohura kanë rënë në pronat e zbrazëta të serbëve të Kosovës, të cilët janë zhvendosur nga qyteti i Prizrenit; dy prona u dëmtuan më 30 maj 2010 dhe një tjetër më 31 korrik 2010.⁶⁰ Në asnjë nga forumet komunale nuk u diskutua për incidentet në fjalë, ndërsa komuna nuk lëshoi ndonjë deklaratë dhe nuk zhvilloi ndonjë informim të komunitetit të prekur. Më 15 nëntor 2010, janë thyer dritaret e shtëpive të zbrazëta të të kthyerve në fshatin Zoçishtë/Zociste në Komunën e Rahovecit/Orahovac. Edhe në këtë rast, nuk ka pasur ndonjë përgjigje në formë të dënimit të incidentit nga institucionet komunale dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të informimit apo riparimit të shtëpive.

⁵⁸ Përfaqësuesi ashkali në KKSBB, objekti i komunës në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, intervistë personale, 13 janar 2011.

⁵⁹ Përfaqësuesi serb i fshatit Novake/Novak dhe anëtar i KKSBB-së, objekti komunal i Prizrenit, intervistë personale, 14 janar 2011.

⁶⁰ Incidenti i 30 majit 2010 fillimisht u klasifikua nga policia si dyshim për zjarrvënje, ndonëse raporti i mëvonshëm i departamentit të zjarrfikësve sugjeronte se zjarri ishte i rastësishëm. Rasti i 31 korrikut 2010 nuk u regjistrua nga policia, prandaj nuk kishte as hetime për rastin.

4. KËSHILLAT KOMUNALË PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB) – REAGIMET KOMUNALE NË INCIDENTET E SIGURISË QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË

I vetmi mekanizëm aktual me mandat për t'i artikuluar dhe udhëzuar reagimet komunale ndaj incidenteve të rënda të sigurisë janë KKSBB-të, të cilat janë “organe kryesore konsultative të komunave për çështje të sigurisë, e të cilat, në bashkëpunim me policinë, shqyrtojnë dhe zgjidhin të gjitha çështjet e sigurisë për komunitetet bë interes të të gjithëve brenda një komune”.⁶¹ Çdo komunë duhet ta ketë të themeluar një KKSBB⁶², dhe të përfshijë përfaqësim të barabartë të të gjitha “komuniteteve etnike” që banojnë në atë rajon, si dhe hisedarëve tjerë relevantë⁶³. KKSBB kryesohet nga kryetari i komunës⁶⁴ dhe i “identifikon brengat lidhur me sigurinë publike dhe rekomandon [siguri në bashkësi] plane veprimi [...] në bashkëpunim me [...] komunitetet lokale për të adresuar, jo vetëm krimin, por edhe “frikën nga krimi””⁶⁵. Gjithashtu, KKSBB ka mandat për të ndërtuar besimin ndërmjet policisë dhe banorëve “përmes themelimit të partneriteteve dhe iniciativave të përbashkëta për t'i zgjidhur problemet e sigurisë në çdo komunitet”, dhe të hartojë një “plan vjetor veprimi” për siguri në komunitet.⁶⁶

KKSBB-të do të duhej të mbajnë takime së paku dhjetë herë në vit dhe të mbajnë e t'i dërgojnë procesverbalet e të gjitha takimeve tek ministritë relevante (Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) për t'i lehtësuar aktivitetet e tyre monitoruese⁶⁷, ndërsa kryetari i komunës do të duhej t'i raportonte kuvendit komunal përkitazi me aktivitetet e KKSBB-së⁶⁸. KKSBB-ja duhet të konsultohet me forumet lokale të sigurisë kur ka të tilla të themeluara⁶⁹ dhe të mbajë dy takime publike konsultative me komunitetet në vit për të diskutuar dhe për t'i adresuar brengat e tyre të sigurisë⁷⁰. Për më tepër, KKSBB-të duhet të hartojnë plan vjetor të veprimit për sigurinë në bashkësi. Përfundimisht, komunat kanë një obligim për të siguruar që përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në KKSBB të ju sigurohet përkthim i duhur në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe e papenguar e tyre në këtë organ.⁷¹ Ftesat, rendi i ditës dhe materialet e lëshuara lidhur me punën e KKSBB-ve duhet të vihen në dispozicion së paku në gjuhën shqipe dhe atë serbe,

⁶¹ Shih shënimin 3 më lart, neni 3(2)

⁶² Po aty, neni 1.

⁶³ Po aty, neni 3.

⁶⁴ Po aty, neni 8.1.

⁶⁵ Po aty, neni 4

⁶⁶ Po aty, neni 11.

⁶⁷ Po aty, neni 7.

⁶⁸ Po aty, neni 8.

⁶⁹ Po aty, neni 10.

⁷⁰ Po aty, neni 11.

⁷¹ Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006, neni 7.2 thekson që “[ç]do person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare”. Neni 7.4 thekson që, “shënimet e takimeve [...] mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës”. Gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhë zyrtare të Kosovës prandaj dhe në çdo komunë të saj. Veç kësaj, gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në Dragash/Dragaš dhe Prizren dhe gjuha turke është gjuhë zyrtare në Mamuşa/Mamushë/Mamuša dhe Prizren. Gjuhët në përdorim zyrtar kanë status të ngjashëm me atë të gjuhëve zyrtare por përkthimi duhet të kërkohet dhe nuk sigurohet me automatizëm. Gjuha boshnjake është gjuhë në përdorim zyrtar në Istog/Istok dhe Pejë/Peć; Gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar në Gjiilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn dhe Prishtinë/Priština.

krahas shërbimeve të përkthimit në mënyrë që folësit e cilëndo nga këto gjuhë të mund të komunikojnë lirshëm gjatë takimeve.

4.1. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

KKSB-të janë themeluar në dhjetë nga njëmbëdhjetë komunat⁷² në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, me shkallë të ndryshme të pajtueshmërisë me standardet e zbatueshme. Për shembull, në Ferizaj/Uroševac KKSB-ja takohet vetëm pesë herë në vit nga dhjetë sa e parasheh ligji; në Gjilan/Gnjilane katër herë; në Viti/Vitina gjashtë herë; në komunën e Klokotit/Kllkotit me shumicë serbe të Kosovës pesë herë; dhe në Kamenicë/Kamenica dy herë. KKSB-ja në komunën e Štrpcë/Shtërpçës me shumicë serbe të Kosovës e ka mbajtur vetëm takimin inaugurues në shtator 2010 dhe zyrtarët komunalë e konsultuar nga OSBE-ja e kanë sqaruar mungesën e pajtueshmërisë duke theksuar se mungesa e incidenteve ndëretnike në komunë ka bërë që KKSB-së mos t'i jepet prioritet.⁷³ Komuna e Hanit të Elezit/Đeneral Jankovic dhe Kaçanikut/Kaçanik me shumicë shqiptare të Kosovës ishin të vetmet në rajonin e Gjilanit/Gnjilane ku KKSB-të janë takuar dhjetë herë në vitin 2010, ashtu siç parashihet. Komuna e Novo Brdo/Novobërdës me shumicë serbe të Kosovës ka themeluar KKSB-në për herë të parë më 2008. Megjithatë, ajo nuk ka pasur asnjë takim në vitin 2010 dhe prandaj ka dështuar që të veprojë në përputhje me obligimet e parapara gjatë periudhës raportuese. Tre gra serbe në komunën e Kamenicës/Kamenica, dhe në komunat e Klokot/Kllkotit janë të vetmet përfaqësuese të gjinisë femërore të KKSB-ve në rajon.

Në shumicën e komunave, kryetarët i kanë kryesuar vetëm disa, nëse ndonjë, të seancave të KKSB-ve, duke i deleguar shpesh detyrat e tyre tek zëvendëskryetarët e komunave apo tek zyrtarët tjerë, me përjashtim të komunës së Ferizajt/Uroševac, Štrpcë/Shtërpçës dhe Vitisë/Vitina ku kryetarët i kryesuan ato takime që u mbajtën. Procesverbalet nga seancat e KKSB-ve, jetike për t'i mundësuar ministrive relevante mbikëqyrjen e punës së tyre, janë mbajtur dhe dërguar vetëm nga komuna e Ferizajt/Uroševac, Hanit të Elezit/Đeneral Jankovic, Kaçanikut/Kaçanik, Klokot/Kllkotit dhe Vitisë/Vitina. Vetëm KKSB-ja e Ferizajt/Uroševac ka raportuar rregullisht tek kuvendi komunal për aktivitetet e tij, derisa KKSB-ja e Klokot/Kllkotit ka raportuar vetëm një herë. Të gjitha KKSB-të tjera në rajon nuk kanë respektuar këtë aspekt të rëndësishëm të mbikëqyrje legislative.

Planet komunale të veprimit për siguri në bashkësi janë hartuar në komunën e Ferizajt/Uroševac, Gjilanit/Gnjilane, Hanit të Elezit/Đeneral Jankovic, Kaçanikut/Kaçanik, Klokot/Kllkotit, Štrpcë/Shtërpçës dhe Vitisë/Vitina. Takimet e obligueshme publike, të rëndësishme për ngritjen e vetëdijes për punën e KKSB-ve, nuk janë mbajtur në asnjë nga komunat ku janë të themeluara këto organe. Përkthimi me gojë gjatë takimeve dhe materialet e përkthyer, duke përfshirë rendet e ditës dhe procesverbalet, nuk janë ofruar rregullisht në të gjitha KKSB-të, duke e vështirësuar kështu mundësinë e disa përfaqësuesve të tyre për përgatitje adekuate para takimeve dhe pjesëmarrje efektive dhe aktive.

⁷² Në kohën e raportimit, komuna e themeluar rishtas e Ranilug/Ranillugut ende nuk e ka themeluar KKSB-në, pavarësisht nga avokimi i rregullt nga OSBE-ja për një gjë të tillë, ndërsa komuna e Parteš/Parteshit themeloi KKSB-në në 2011.

⁷³ Zëvendëskryetari shqiptar i komunës për komunitete dhe kryesuesi shqiptar i zyrës për emergjenca komunale, komuna e Štrpcë/Shtërpçës, intervista personale, 19 janar 2011.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi (KLSB) janë themeluar në komunat Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Klokot/Klllokot dhe Viti/Vitina. Përfaqësuesit nga katër KLSB-të në rajonin e Gjilanit/Gnjilane⁷⁴ kanë marrë pjesë rregullisht në takimet e KKSB-ve. KLSB-ja në Vrbovac/Vërboc përfaqësohet me një anëtar në KKSB-në e Klokot/Klllokot të banuar me shumicë serbe të Kosovës. Në komunën e Vitisë/Vitina, që të tre KLSB-të në zonë ishin të përfaqësuara në KKSB.⁷⁵ KKSB-ja në Kamenicë/Kamenica përfshinë përfaqësues nga pesë KLSB-të ekzistuese në komunë, të cilët marrin pjesë në takimet me rrotacion, ashtu siç janë pajtuar vetë përfaqësuesit e KLSB-ve.⁷⁶

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja efektive e komuniteteve joshumicë në KKSB-të e rajonit dallon nga komuna në komunë, gjë që ka pasur ndikim në kapacitetin e KKSB-ve që t'i adresojnë në mënyrë efektive brengat e tyre të sigurisë dhe rendit. Në komunën e Ferizajt/Uroševac, përfaqësuesi serb i Kosovës bëri të ditur që shërbimet e përkthimit në gjuhën serbe ishin në dispozicion, gjë që ia mundësonte atij pjesëmarrjen e plotë në procedura⁷⁷, ndërsa anëtari i komunitetit ashkali e theksoi efikasitetin e mekanizmit⁷⁸. Megjithatë, KKSB-ja ka dështuar t'i përfshijë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve joshumicë që janë të pranishme në komunë: derisa përfaqësuesit e komunitetit serb, rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës morën pjesë në takime, nga komuniteti boshnjak i Kosovës nuk kishte asnjë përfaqësues. Sesioni i KKSB-së i 2 marsit 2010 e diskutoi incidentin e sipërpërmendur të 23 janarit 2010, kur një i mitur i komunitetit ashkali të Kosovës ishte therur në qytetin e Ferizajt/Uroševac.⁷⁹ Në sesionin tjetër të KKSB-së, policia diskutoi për çështjen e dhunës nëpër shkolla dhe raportoi për operacionet e tyre reaguese për kërkimin dhe konfiskimin e thikave. Megjithatë, në sesionin e nëntorit të KKSB-së nuk është bërë fjalë fare për plaçkitjen e vazhdueshme të shtëpive të serbëve të Kosovës që nga tetori 2010.⁸⁰

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, KKSB-ja i ka përfshirë me sukses të gjitha komunitetet joshumicë, me prani të rregullt të përfaqësuesve të komunitetit serb, turk dhe rom të Kosovës. OSBE-ja ka intervistuar përfaqësuesit e komunitetit rom⁸¹ dhe atij serb⁸² të Kosovës, të cilët e kanë lavdëruar këtë mekanizëm. Megjithatë, anëtari turk i Kosovës e ka kritikuar faktin që KKSB-ja është takuar vetëm katër herë⁸³, dhe ka bërë të ditur se kjo ishte e pamjaftueshme për t'i adresuar në mënyrë efektive brengat e

⁷⁴ KLSB-të, shih shënimi 5, *sipër*, janë themeluar në fshatrat Abdullah Presheva/Abdula Preševo, Livoç i Epërm/Gornji Livoč, Parteš/Partesh dhe Poneš/Ponesh.

⁷⁵ KLSB-të, po aty, janë themeluar në fshatrat Pozharan/Požaranje, Smirë/Smira, dhe Vërbani/Vrbani. KLSB Vrbovac/Vërboc tani përfaqësohet në KKSB-në e komunës së re të Klokot/Klllokotit.

⁷⁶ KLSB-të, po aty, janë të themeluara në fshatrat Berivojce/Berivojcë, Karaçevë/Karačevo, Kololeç/Kollolëç, Muçivërc/Mučivrcë, dhe Shipashnicë e Epërme/Gornja/Šipašnica.

⁷⁷ Intervistë personale me anëtarin serb të Kosovës të KKSB-së, qyteti i Ferizajt/Uroševac, 19 janar 2011.

⁷⁸ Intervistë personale me anëtarin ashkali të Kosovës të KKSB-së, qyteti i Ferizajt/Uroševac, 19 janar 2011.

⁷⁹ Shih p. 9, *sipër*.

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Dy përfaqësues të komunitetit rom të Kosovës të KKSB-së në Gjilan/Gnjilane, intervista personale në Qendrën e Komunitetit Rom dhe ndërtesën komunale të Gjilanit/Gnjilane përkatësisht, 18 janar 2011.

⁸² Intervistë personale me anëtarin serb të Kosovës të KKSB-së në Gjilan/Gnjilane, ndërtesa komunale Gjilan/Gnjilane, 18 janar 2011.

⁸³ Intervistë personale me anëtarin turk të Kosovës të KKSB-së në Gjilan/Gnjilane, ndërtesa komunale Gjilan/Gnjilane, 19 janar 2011.

komunitetit për siguri dhe rend në komunë. Për më tepër, ndonëse ka siguruar ftesa të rregullta dhe rende të ditës për takime në gjuhën serbe, gjatë seancës së 28 tetorit 2010 nuk është ofruar përkthim, pavarësisht se ka pasur prani të disa përfaqësuesve të komunitetit serb të Kosovës dhe zyrtarëve komunalë që nuk flisnin gjuhën shqipe. Përdhosja e varreve të serbëve të Kosovës në varrezat ortodokse serbe në qytetin e Gjilanit/Gnjilane më 18 shkurt 2010⁸⁴ nuk u diskutua kurrë në KKSB, meqë asnjë seancë nuk ishte mbajtur nga seanca inauguruese e 20 janarit 2010 dhe takimit të radhës të 15 korrikut 2010. Një anëtar i Këshillit të kishës ortodokse serbe në qytetin e Gjilanit/Gnjilane bëri me dije se dështimi i KKSB-së për t'u mbledhur dhe për ta adresuar çështjen e përdhosjes hedh dyshime rreth dobisë së mekanizmit.⁸⁵

Në komunën e Vitisë/Vitina, përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës kanë marrë pjesë rregullisht në takimet e KKSB-së. Megjithatë, dështimi për të siguruar përkthim në gjuhën serbe të materiale më të rëndësishme dhe gjatë takimeve e kanë vështirësuar pjesëmarrjen e tyre efektive në këtë mekanizëm.⁸⁶ Zyrtari komunal për kthim nga komuniteti serb i Kosovës është ankuar për këtë çështje gjatë sesionit të KKSB-së të 27 shtatorit 2010. Megjithatë, çështja vazhdon e pandryshuar. Mungesa e një përfaqësuesi të komunitetit kroat të Kosovës është gjithashtu çështje brengje, ku përfaqësuesit e komunitetit pohojnë se nuk janë ftuar kurrë të marrin pjesë në takimet e KKSB-së dhe që brengat e vazhdueshme të sigurisë brenda këtij komuniteti të cenueshëm⁸⁷ nuk janë adresuar nga mekanizmi.⁸⁸

Në komunën e Hanit të Elezit/Đeneral Jankovic të banuar kryesisht me banorë shqiptarë të Kosovës, nuk kishte përfaqësim të komunitetit të vogël boshnjak të Kosovës në KKSB.⁸⁹ Pesë romët që banojnë në komunën e Kaçanikut/Kaçanik me shumicë shqiptare të Kosovës pohuan që nuk janë ftuar të marrin pjesë në takimet e KKSB-së.⁹⁰ Në katër prej pesë takimeve të mbajtura në KKSB-së në komunën e Klokot/Klllokotit me shumicë serbe të Kosovës është siguruar përkthim në gjuhën shqipe i procesverbaleve dhe rendeve të ditës, ndonëse përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës pohuan që kanë qenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në të gjitha sesionet.⁹¹

Gjatë takimeve të KKSB-së më 26 korrik 2010, përfaqësuesit serbë të fshatit të Klokot/Klllokotit dhe Grncar/Gërncarit janë ankuar për incidente të keqtrajtimit nga individë—siç pohohet nga shqiptarë të Kosovës—gjatë ngasjes së veturës nëpër fshatrat

⁸⁴ Shih p. 7-8, sipër.

⁸⁵ Intervistë personale me anëtarin serb të Kosovës të Këshillit të Kishës Ortodokse, hapësirat e Këshillit në qytetin e Gjilanit/Gnjilane, 14 janar 2011.

⁸⁶ Intervistë personale me anëtarin serb të Kosovës të KKSB-së, ndërtesa komunale Viti/Vitina 17 janar 2011.

⁸⁷ Shih shënimin 31 më lart.

⁸⁸ Intervistë personale me përfaqësuesin e komunitetit kroat të Kosovës në shtëpinë e tij në fshatin Lletnicë/Letnica, komuna e Vitisë/Vitina, 28 dhjetor 2010.

⁸⁹ Komuniteti boshnjak i Kosovës është gjerësisht i integruar në komunitetin shumicë dhe nuk ka kërkuar pjesëmarrje në mekanizmat e themeluar për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve joshumicë.

⁹⁰ Pesë anëtarët e komunitetit rom të Kosovës të cilët jetojnë në komunën e Kaçanikut/Kaçanik janë gjerësisht të integruar me komunitetin shumicë shqiptar të Kosovës dhe raportojnë se nuk kanë brenga të tanishme të sigurisë. Megjithatë, duhet theksuar që kjo nuk do të thotë që hiqet obligimi ligjor i KKSB-së për të siguruar përfaqësim të çdo komunitet etnik në komunë brenda mekanizmit.

⁹¹ Intervista personale me katër përfaqësues shqiptarë të Kosovës të KKSB-së, ndërtesa komunale Klokot/Klllokot, 17 janar 2011.

e tyre. Komandanti i stacionit të policisë premtoi që do të shtojë numrin e patrullave të policisë në zonë, ndërsa koordinatori i KKS-së premtoi që do të mbajë takime javore me banorët për ta monitoruar situatën. Megjithatë, nuk ka pasur trajtim të mëtijmë të çështjes në takimet vijuese të KKS-së.

KKS-ja e komunës së Novo Brdo/Novobërdës me shumicë serbe të Kosovës përfshinë përfaqësues nga të gjitha komunitetet. Megjithatë, fakti që nuk ka pasur asnjë takim në vitin 2010, nënkupton që tre sulmet ndaj serbëve të Kosovës në dhe rreth fshatit Paralovo/Parallovë më 15 mars, 30 nëntor dhe 28 dhjetor 2010⁹² nuk janë adresuar nga këshilli. Në komunën e Štrpce/Shtërpçës me shumicë serbe të Kosovës shqiptarët e Kosovës morën pjesë në takimin e vetëm të mbajtur nga KKS-ja, nga komuniteti i vogël i romëve nuk u emërua askush. Në Kamenicë/Kamenica, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës morën pjesë në dy takimet e mbajtura, por edhe këtu nuk kishte përfaqësues të komunitetit të vogël të romëve të Kosovës. Përfaqësuesit serbë të Kosovës bënë të ditur se në të dy takimet është ofruar përkthim, duke ua mundësuar atyre pjesëmarrjen e plotë në procedura. Megjithatë, dy prej tyre theksuan se efikasiteti i mekanizmit mund të rritet nëse do të mbaheshin më shumë takime dhe nëse do t'i adresonte brengat specifike të sigurisë së komunitetit në vend se të fokusohet në çështjet e përgjithshme të sigurisë publike.⁹³

4.2. Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, vetëm KKS-ja në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn ishte funksionale gjatë vitit 2010. KKS-të nuk janë themeluar në komunat e Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potok/Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit⁹⁴. Komuna e Mitrovicës/Mitrovica themeloi KKS-në në muajin prill 2009, por ai u mblodh vetëm një herë, ndërkaj në vitin 2010 nuk pati asnjë takim. Në mënyrë të ngjashme, KKS-ja u themelua në janar të 2010 edhe në komunën e Skenderajt/Srbica, por ajo nuk mbajti asnjë takim tjetër gjatë periudhës për të cilën raportohet.

KKS-ja e Vushtrrisë/Vučitrn u mblodh dhjetë herë në vitin 2010, që është në përputhje të plotë me obligimet ligjore. Takimet kryesohen rregullisht nga kryetari i komunës, procesverbalet e takimeve i dërgohen ministrive përkatëse dhe në të gjitha takimet ka pjesëmarrje të komunitetit serb (një grua), turk, rom dhe ashkali të Kosovës. Përfaqësuesit e tre komuniteteve të fundit të lartcekura në KKS e lavdëruan efikasitetin e mekanizmit dhe mundësinë për pjesëmarrje aktive në atë.⁹⁵ Megjithatë, përfaqësuesi serb ishte i mendimit se kontributi i KKS-së ishte kryesisht simbolik dhe se ai kishte kapacitet të kufizuar për t'i zgjidhur çështjet, ndonëse e pranonte se i mundësohej pjesëmarrje e plotë në procedura.⁹⁶ Një banor serb i Kosovës i fshatit Gojbulja/Gojbulë u ankua në OSBE se incidentet e raportuara të sigurisë nuk diskutoheshin nga KKS-ja, ndërkohë që edhe incidente të tjera të sigurisë të

⁹² Shih p. 8, sipër.

⁹³ Intervistë personale me përfaqësuesin serb të Kosovës të KKS-së në Kamenicë/Kamenica, qyteti Kamenicë/Kamenica, 18 janar 2011.

⁹⁴ KKS-të nuk ekzistojnë në komunën e Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut/Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçanit për shkak se në këto komuna aplikohet ligji i Serbisë.

⁹⁵ Intervistë personale me përfaqësuesin turk, rom dhe ashkali të Kosovës të KKS-së së Vushtrrisë/Vučitrn, më 20, 21 dhe 26 janar 2011, përkatësisht.

⁹⁶ Intervistë personale me përfaqësuesin serb të Kosovës të KKS-së në Vushtri/Vučitrn, 18 janar 2011.

raportuara në zona të tjera të komunës⁹⁷ mbeteshin pa u adresuar.⁹⁸ Përkthimi në gjuhën serbe ofrohej rregullisht, por procesverbalet ishin vetëm në gjuhën shqipe. KKSBB-ja nuk i ka raportuar aktivitete para kuvendit komunal, nuk ka hartuar plan të veprimit komunal për siguri në bashkësi dhe nuk i ka mbajtur dy takimet e obligueshme publike në vitin 2010.

Në të gjitha komunat e rajonit të Mitrovicës/Mitrovica janë raportuar incidentet të konsiderueshme që i kanë prekur komunitetet joshumicë. Dështimi i këtyre komunave për përputhshmëri në kërkesat ligjore të zbatueshme për KKSBB-të⁹⁹ të cilat aplikoheshin ka lënë një vakum të konsiderueshëm në kapacitetin e tyre për t'u përgjigjur me efikasitet ndaj këtyre incidenteve dhe të mbrojtë e të promovojë sigurinë e komuniteteve joshumicë. Për më tepër, KLSB-të në zonë¹⁰⁰ nuk kanë mundur t'i ushtrjnë funksionet e tyre për mungesë të KKSBB-ve.

4.3. Rajoni i Pejës/Peć

Në rajonin e Pejës/Peć, që të gjashtë komunat i kanë themeluar KKSBB-të e tyre, të cilat kanë vepruar në shkallë të ndryshme në përputhje me standardet përkatëse. Në Deçan/Dečane, KKSBB-ja ka mbajtur katër nga dhjetë takimet e obligueshme në vitin 2010, në Gjakovë/Đakovica dy, në Istog/Istok gjashtë, në Klinë/Klina pesë, në Pejës/Peć tetë dhe në Junik vetëm një. Në Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica dhe Junik/Junik, takimet e mbajtura janë kryesuar nga kryetarët e komunave gjegjëse. Në Istog/Istok dhe Klinë/Klina kryetarët e komunave i kanë kryesuar vetëm disa prej takimeve, derisa në Pejës/Peć kryetari i komunës nuk e ka kryesuar asnjë prej takimeve, duke i dërguar zëvendëskryetarët si kryesues. Procesverbalet janë bërë dhe dërguar për shqyrtim tek ministritë përkatëse vetëm në Gjakovë/Đakovica dhe Klinë/Klina. Në Istog/Istok dhe Pejës/Peć, procesverbalet e takimeve të KKSBB-ve janë bërë por i janë dërguar gabimisht Asociacionit të Komunave të Kosovës në vend të ministrive relevante. Në Junik/Junik është bërë procesverbali i një takimi të mbajtur të KKSBB-së, që është kryesuar nga kryetari i komunës, por nuk i është dërguar ministrive relevante. Vetëm KKSBB-ja e Istogut/Istok i ka raportuar aktivitetet në kuvendin komunal, derisa pesë KKSBB-të tjera nuk i kanë respektuar obligimet përkatëse në këtë drejtim.

KKSBB-të e Istogut/Istok dhe Pejës/Peć i kanë hartuar planet komunale të veprimit për siguri në bashkësi për vitin 2010. Në kohën kur është shkruar ky raport, plani i veprimit i përgatitur nga KKSBB-ja e Gjakovës/Đakovica ishte në pritje të hartimit dhe miratimit final, ndërsa Juniku/Junik dhe Deçani/Dečane nuk kishin ndërmarrë veprime në këtë drejtim. Vetëm KKSBB-ja në Pejës/Peć i ka mbajtur dy konsultimet e obligueshme publike në vitin 2010, derisa pesë KKSBB-të tjera dështuan në shfrytëzimin e kësaj mundësie për të ngritur profilin e aktiviteteve të tyre në mesin e publikut. Përkthimet e materialeve dhe gjatë takimeve nuk janë ofruar gjithmonë për përfaqësuesit e KKSBB-ve, gjë që ka ndikuar negativisht në mundësinë e tyre për përgatitje të duhur dhe

⁹⁷ Shih p. 12, *më sipër*.

⁹⁸ Intervistë telefonike me një banor serb të Kosovës të fshatit Gojbulja/Gojbulë, komuna e Vushtrisë/Vučitrm, 21 janar 2011.

⁹⁹ Shih p. 10-12, *më sipër*.

¹⁰⁰ KLSB-të, shih shënimi 5, *sipër*, janë të themeluara në fshatrat Suvo Grlo/Syrganë (komuna e Skenderajt/Srbica), Çaber/Čabra (Zubin Potok), dhe Lipe/Lipa (Zvečan/Zvečan).

pjesëmarrje efektive dhe aktive në takime. Në mesin e KKSBB-ve të rajonit nuk ka përfaqësues të komuniteteve joshumicë nga gjinia femërore.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja efektive e komuniteteve joshumicë në KKSBB-të e rajonit dallon nga komuna në komunë, gjë që ka pasur ndikim në kapacitetin e organeve për t'i adresuar në mënyrë efektive brengat e sigurisë të këtyre komuniteteve. Në KKSBB-në e Deçanit/Deçane, kryesuesi i ZKKK-së – boshnjak i Kosovës – u caktua nga komuna për t'i përfaqësuar interesat e të gjitha komuniteteve joshumicë, duke përfshirë serbët, egjiptianët, ashkalitë dhe romët e Kosovës, një vendim ky që është në kundërshtim me standardet e zbatueshme. Përfaqësuesi boshnjak i Kosovës e theksoi mundësinë që ka për të marrë pjesë plotësisht në diskutime, meqë ai e flet gjuhën shqipe dhe në përgjithësi shërbimet e përkthimit janë të siguruar. Ai sugjeroi se një ngritje në rrjedhën e informacioneve ndërmjet KKSBB-së dhe komuniteteve do ta forconte punën e këtij organi dhe besonte se fushatat e informimit për ngritje të vetëdijes për ekzistimin dhe mandatin e këshillit gjithashtu do të përmirësonte efikasitetin e tij.¹⁰¹ Një punonjës serb i Kosovës në ZKKK e përcjelli frustrimin e mungesës së përfaqësimit të komuniteteve të tjera në KKSBB, në veçanti të serbëve dhe malazezëve të Kosovës, dhe theksoi se do të dëshironin të shohin më shumë angazhim nga KKSBB-ja në adresimin e brengave të sigurisë të komuniteteve të tyre.¹⁰²

Në komunën e Gjakovës/Đakovica, egjiptianët e Kosovës janë i vetmi komunitet joshumicë që përfaqësohen në KKSBB përmes zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal; nuk janë caktuar përfaqësues tjerë të komunitetit rom, ashkali apo boshnjak të Kosovës. Një anëtar i shoqërisë civile, shqiptar i Kosovës, pohon se i përfaqëson interesat e të gjitha komuniteteve joshumicë në komunë sepse ka përvojë të mëhershme në punë me çështjet e të drejtave të komuniteteve në një organizatë të shoqërisë civile.¹⁰³ Mungesa e përfaqësimit të komuniteteve mund të ofrojë sqarim përse në takimin e KKSBB-së të 7 korrikut 2010, janë diskutuar vetëm çështje të sigurisë publike dhe aspak nuk është bërë fjalë për incidentet e sigurisë të raportuara në mars dhe maj 2010¹⁰⁴ që e kanë prekur komunitetin egjiptian dhe atë boshnjak të Kosovës. Përkthimi në gjuhën serbe nuk është ofruar meqë të gjithë përfaqësuesit e KKSBB-së e flasin gjuhën shqipe. Ndonëse përfaqësuesi egjiptian i Kosovës në KKSBB beson fuqishëm se KKSBB-ja ka potencialin për t'i adresuar në mënyrë efektive brengat e sigurisë të komuniteteve, kërkesa e tij për mbajtjen e një takimi të KKSBB-së për të diskutuar rreth çështjeve të sigurisë që i prekin komunitetet joshumicë në komunë nuk u aprovua kurrë.¹⁰⁵

Në komunën e Istogut/Istok, përfaqësuesit e komunitetit serb, boshnjak, egjiptian dhe komunitetit rom të Kosovës janë të caktuar dhe marrin pjesë thajse në të gjitha takimet e KKSBB-së. Megjithatë, komuniteti i malazezëve të Kosovës nuk është i përfaqësuar. Takimet e KKSBB-së i kanë adresuar incidentet e sigurisë të raportuara në vendin e kthimit të serbëve të Kosovës në Zallq/Žač¹⁰⁶, fakt ky që është lavdëruar nga anëtar

¹⁰¹ Intervistë personale me kryesuesin e ZKKK-së në Deçan/Deçane dhe anëtarin e KKSBB-së nga komuniteti boshnjak i Kosovës, 10 janar 2011.

¹⁰² Intervistë personale me zyrtarin serb të Kosovës në ZKKK të Deçanit/Deçane, ndërtesa komunale Deçan/Deçane, 10 janar 2011.

¹⁰³ Intervistë personale me anëtarin shqiptar të Kosovës në KKSBB-në në Gjakovë/Đakovica, qyteti i Gjakovës/Đakovica, 11 janar 2011.

¹⁰⁴ Shih shënimin 51 dhe 52, sipër.

¹⁰⁵ Intervistë personale me zëvendëskryesuesin e kuvendit komunal dhe anëtarin e KKSBB-së nga komuniteti egjiptian i Kosovës, qyteti Gjakovë/Đakovica, 12 janar 2011.

¹⁰⁶ Shih p.13, sipër.

serb i Kosovës në KKS¹⁰⁷. Megjithatë, serbët e Kosovës që ishin cak sulmi në disa incidente në Zallq/Žač nuk kishin dijeni se KKS¹⁰⁸-ja kishte diskutuar për ngjarjet dhe u ankuan se përfaqësuesi i tyre nuk i kishte informuar ata për këtë pas incidenteve.¹⁰⁸ Ndonëse përkthimi në gjuhën serbe ishte në dispozicion gjatë takimeve, materialet e takimeve përpiloheshin kryesisht në gjuhën shqipe. Anëtari egjiptian i Kosovës i KKS¹⁰⁹-së e lavdëroi KKS¹⁰⁹-në që i ka mundur atij pjesëmarrje të plotë në procedura, por theksoi nevojën për dërgimin apo dorëzimin e materialeve shumë më herët në mënyrë që të ju mundësohet përfaqësuesve përgatitja për takime dhe për vijim konsistent të çështjeve të ngritura.¹⁰⁹

Në komunën Klinës/Klina, përfaqësuesit e komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom të Kosovës kanë marrë pjesë rregullisht në takimet e KKS¹¹⁰-së dhe e kanë lavdëruar efikasitetin e mekanizmit.¹¹⁰ Megjithatë, jo të gjitha komunitetet joshumicë në komunë ishin të përfaqësuara në KKS¹¹¹: nuk është caktuar asnjë përfaqësues nga një familje e mbetur e malazezëve të Kosovës në qytetin e Klinës/Klina dhe përfaqësuesi i serbëve të Kosovës në këshill nuk kishte marrë pjesë në të gjitha takimet. KKS¹¹²-ja ka adresuar një sërë çështjes, nga rendi publik deri tek çështjet e sigurisë lidhur me kthimin e serbëve të Kosovës në një fshat të komunës. Megjithatë, gjuajtja me gurë e shtëpive të serbëve të kthyer të Kosovës në Klinë/Klina në janar 2010¹¹¹ nuk u adresua nga KKS¹¹³-ja, meqë u themelua në korrik. Një përfaqësues i të vetmes KLSB në zonë – në fshatin Dolle-Dresnik/Dolac-Dresnik – u caktua në KKS¹¹⁴. Megjithatë, komuna nuk i kishte detajet e kontaktit të tij dhe e kishte të vështirë t’ia dërgonte ftesat.

Në komunën e Pejës/Peć, serbët, boshnjakët, egjiptianët dhe romët e Kosovës ishin të përfaqësuar në KKS¹¹⁵, por nuk merrnin pjesë rregullisht, derisa komuniteti goran dhe malazez i Kosovës nuk ishin të përfaqësuar. Përkthimi i njëkohshëm në gjuhën shqipe dhe atë serbe është siguruar rregullisht por përfaqësuesit e serbëve të Kosovës theksuan që rendi i ditës dhe procesverbali ishin shpërndarë vetëm në gjuhën shqipe.¹¹² KLS¹¹³-ja në fshatin Ljevoša/Levoshë, ku jetojnë serbët e Kosovës, emëroi një përfaqësues i cili mori pjesë në shumicën e mbledhjeve ndonëse ai u ankua se ftesa dhe rendi i ditës i ishin dërguar vonë dhe vetëm në gjuhën shqipe, gjë që ka penguar atë të përgatitet me kohë.¹¹³ Gjatë mbledhjeve u diskutuan një gamë e shumëllojshme e çështjeve të sigurisë publike, por këto nuk përfshinë incidentet e sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë në komunë dhe që kanë prekur posaçërisht boshnjakët e Kosovës, egjiptianët e Kosovës dhe romët e Kosovës.¹¹⁴ Anëtari boshnjak i Kosovës i KKS¹¹⁵-së u ankua se gjatë mbledhjeve adresohen siguria publike dhe çështjet e sigurisë në përgjithësi, pa u përqendruar në komunitetet joshumicë, gjë që mund të shpjegojë

¹⁰⁷ Intervistë personale në Čerkolez/Crkolez, në shtëpinë e anëtarit serb të Kosovës të KKS¹¹⁵-së në Istog/Otok, 13 janar 2011.

¹⁰⁸ Intervista personale me të kthyerit serbë të Kosovës në fshatin Zallq/Žač dhe Osojane/Osojan, 10–11 janar 2011.

¹⁰⁹ Intervistë nga OSBE e anëtarit egjiptian të Kosovës të KKS¹¹⁵-së në Istog/Istok, 11 janar 2011, Istog/Istok.

¹¹⁰ Përfaqësues ashkali, romë dhe egjiptianë në KKS¹¹⁵-në në Klinë, të intervistuar ndaras nga OSBE-ja më 12-13 janar 2011 në shtëpitë e tyre në fshatrat Klinavc/Klinavac, Dollovë/Dollovo, dhe Shtupel/Stupelj përkatësisht.

¹¹¹ Shih f. 12-13, *sipër*.

¹¹² Anëtari serb i Kosovës i KKS¹¹⁵-së në Pejë/Peć, i cili u intervistua nga OSBE-ja më 29 dhjetor 2010 në shtëpinë e tij në fshatin Belo Polje/Bellopojë.

¹¹³ Përfaqësuesi serb i Kosovës i KLS¹¹³-së në Ljevoša/Levoshë dhe anëtar i KKS¹¹⁵-së në Pejë/Peć, i cili u intervistua nga OSBE-ja më 11 janar 2011 në shtëpinë e tij në fshatin Ljevoša/Levoshë.

¹¹⁴ Shih fusnotën 51, 52, *më sipër*.

përse sulmi ndaj një boshnjaku të Kosovës, në fshatin Zllapek/Zlopek më 26 tetor 2010¹¹⁵, nuk ishte diskutuar gjatë mbledhjes së radhës të mbajtur më 2 dhjetor 2010.¹¹⁶ Për më tepër, një përfaqësues serb i Kosovës theksoi se nuk kishte marrë përgjigje ndaj një çështjeje të cilën ai e kishte ngritur gjatë mbledhjeve të KKSBB-së dhe se komunitetet janë shumë pak të informuara për ekzistimin dhe mandatin e mekanizmit.¹¹⁷

4.4. Rajoni i Prishtinës/Priştina

Në rajonin e Prishtinës/Priştina, shtatë nga tetë komuna themeluan KKSBB; vetëm komuna e Gračanica/Graçanicës nuk e themeloi atë. Në vitin 2010, KKSBB-ja në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje organizoi vetëm dy nga dhjetë mbledhjet e obligueshme, ndërsa komuna e Lipjanit/Lipljan organizoi tetë mbledhje, komunat Obiliq/Obilić dhe Podujevë/Podujevo tre mbledhje, komuna e Prishtinës/Priştina pesë mbledhje, komuna e Gllgovcit/Gllgovac katër mbledhje dhe komuna e Shtimes/Štimlje 16 mbledhje. Kryetarët e komunave Podujevë/Podujevo dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje kryesuan disa mbledhje, kurse në pesë KKSBB tjera kryetarët kryesuan vetëm disa mbledhje shpeshherë duke ia deleguar këtë përgjegjësi te nënkryetari dhe/ose kryesuesit e kuvendeve komunale. Shumica e KKSBB-ve mbajtën dhe ia dërguan procesverbalin e mbledhjeve të tyre ministrive gjegjëse për shqyrtim, ndërsa komuna e Obiliqit/Obilić e bëri këtë vetëm një herë kurse komuna e Gllgovcit/Gllgovac dështoi ta bëjë këtë tërësisht. Vetëm KKSBB-ja në komunën e Obiliqit/Obilić ka raportuar në kuvendin komunal për veprimtaritë e saja ndërsa të gjitha KKSBB-të tjera dështuan në respektimin e këtij kushti ligjor. KKSBB-të në komunën e Lipjanit/Lipljan dhe atë Obiliqit/Obilić ishin të vetmet që hartuan një plan veprimi komunal për sigurinë në bashkësi për vitin 2010, kurse dy mbledhjet e obligueshme të KKSBB-ve janë mbajtur vetëm në komunën e Shtimes/Štimlje dhe atë të Lipjanit/Lipljan. Dy femra, një serb i Kosovës dhe një boshnjak i Kosovës kanë marrë pjesë në KKSBB në komunën e Obiliqit/Obilić.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja efikase e komuniteteve joshumicë në KKSBB-të e rajonit ndryshoi nga njëra komunë në tjetrën, duke ndikuar kështu në kapacitetin e këtyre mekanizmave për të zgjidhur në mënyrë efektive shqetësimet e komuniteteve në lidhje me sigurinë dhe rendin. Gjashtë nga shtatë KKSBB përshinë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë; vetëm komuna e Gllgovcit/Gllgovac nuk bëri këtë por duhet theksuar që në këtë komunë jetojnë vetëm shqiptarët e Kosovës.

Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, egjiptianëve të Kosovës, romëve të Kosovës dhe ashkalinjëve të Kosovës morën pjesë në mbledhjet e KKSBB-së. Përfaqësuesit e komuniteteve më të vogla boshnjake dhe goranë nuk ishin emëruar, por zyrtarët komunalë të cilët OSBE-ja i konsultoi deklaruan se ata nuk ishin në gjendje që të identifikonin individët për këto pozita, duke qenë se komunitetet ishin shumë të vogla dhe shumë të integruara në komunitetin shumicë. Përkthimi në gjuhën serbe u sigurua. KKSBB-ja diskutoi çështje të sigurisë publike si dhe incidentet e sigurisë

¹¹⁵ Shih faqen 14, *më sipër*.

¹¹⁶ Anëtari boshnjak i Kosovës i KKSBB-së në Pejë/Peć, i cili u intervistua nga OSBE-ja më 14 janar 2011 në shtëpinë e tij në fshatin Vitomiricë/Vitomirica.

¹¹⁷ Anëtari serb i Kosovës i KKSBB-së në Pejë/Peć nga fshati Goraždevac/Gorazhdec, intervistë personale në shtëpinë e tij më 30 dhjetor 2010.

që kanë prekur komunitetet joshumicë. Për shembull, gjatë mbledhjes që u mbajt më 23 prill 2010, përfaqësuesi ashkali i Kosovës ngriti çështjen e dritareve të thyera në katër shtëpi që u takonin familjeve ashkalinje të Kosovës të kthyer në fshatin Nakaradë/Nakarade.¹¹⁸ Megjithatë, përkundër pranisë së përfaqësuesit serb të Kosovës në KKSB, nuk u diskutua përdhosja e varrezave ortodokse serbe në komunë në janar dhe tetor të vitit 2010.¹¹⁹

Në Lipjan/Lipljan, të gjitha komunitetet joshumicë janë ofruar të përfaqësohen në KKSB, domethënë serbët e Kosovës, turqit e Kosovës, romët e Kosovës, ashkalinjtë e Kosovës, malazezët e Kosovës dhe kroatët e Kosovës. Megjithatë, një numër i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë nuk morën pjesë në mbledhje dhe përfaqësuesi malazez i Kosovës dhe ai kroat munguan në të gjitha mbledhjet.¹²⁰ Përkthimi në gjuhën serbe u siguria rregullisht dhe përfaqësuesit e KLSP-së në Janjevo/Janjevë morën pjesë rregullisht në mbledhje. KKSB-ja u mbledh rregullisht dhe diskutoi disa çështje të sigurisë dhe rendit publik që kishin prekur të gjitha komunitetet, ndonëse ajo nuk adresoi çështjen e përdhosjes së varrezave ortodokse serbe në fshatin Rubovce/Rubovc më 30 mars 2010. Në vend të kësaj, ky incident u diskutua gjatë një takimi mujor të sigurisë që u organizua nga policia e Kosovës në zyrat e ZKKK, ku u ra dakord që të shtohen patrullat e policisë. Anëtari serb i Kosovës i KKSB-së pohoi se ai nuk kishte marrë pjesë në mbledhjet e KKSB-së në kohën kur kishte ndodhur incidenti.¹²¹ Anëtari ashkali i KKSB-së lavdëroi mekanizmin si një mënyrë të dobishme për ndarjen e informatave për shqetësimet e sigurisë të komuniteteve tjera në komunë, ndërsa kjo i mundëson komunitetit të tij që të ndërveprojë me institucionet.¹²²

Në Obiliq/Obilić, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, boshnjakëve të Kosovës, egjiptianëve, romëve dhe ashkalinjëve të Kosovës morën pjesë në mbledhjet e KKSB-së, ndonëse komuniteti i vogël malazez nuk ishte i përfaqësuar. KKSB-ja nuk diskutoi në mënyrë të veçantë çështjet e sigurisë, duke u përqendruar në çështjet e rendit publik por përfaqësuesit e KKSB-së lavdëruan efikasitetin e tij për adresimin e çështjeve të preokupimit të përbashkët.¹²³ Megjithatë, njëra prej dy grave në KKSB, gjegjësisht përfaqësuesja e komunitetit boshnjak, theksoi se duhet të ketë më shumë përkushtim dhe vullnet politik për përmirësimin e raportimit dhe zgjidhjes së çështjeve të ngritura nga komunitetet gjatë mbledhjeve.¹²⁴

Në Podujevë/Podujevo, përfaqësuesit e komunitetit rom dhe ashkali, të cilët jetojnë në qytet marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e KKSB-së dhe shprehën kënaqësinë me

¹¹⁸ Shih faqet 15-16, *më sipër*.

¹¹⁹ Shih faqen 14-15, *më sipër*.

¹²⁰ Në rastin e komunitetit malazez të Kosovës, një përfaqësues është kërkuar që të bëhet anëtar i KKSB-së por ai nuk pranoi, ndërsa anëtari kroat i Kosovës ishte emëruar zyrtarisht por mungoi gjatë mbledhjeve.

¹²¹ Anëtari serb i Kosovës i KKSB-së në Lipjan/Lipljan, zyrat e OSBE-së në Lipjan/Lipljan, intervistë personale më 28 janar 2011.

¹²² Anëtari ashkali i Kosovës i KKSB-së në Lipjan/Lipljan, fshati Gadime/Gadimlje, intervistë personale në shtëpinë e tij më 18 janar 2011.

¹²³ Përfaqësuesi serb i Kosovës dhe përfaqësuesi ashkali i Kosovës i KKSB-së në Obiliq/Obilić, zyrat e OSBE-së në Obiliq/Obilić, përkatësisht në fshatin Plementin/Plementina, intervista personale më 12 janar 2011.

¹²⁴ Anëtari boshnjak i Kosovës i KKSB-së në Obiliq/Obilić, zyrat e OSBE-së në Obiliq/Obilić, intervistë personale më 12 dhjetor 2010.

efikasitetin e mekanizmit.¹²⁵ Ndonëse në këtë komunë jeton një komunitet i vogël serb, ai nuk mori pjesë në mbledhjet e KKSBB-së kryesisht për shkak të largësisë dhe shpenzimeve të udhëtimit. KKSBB-ja diskutoi çështjet e përgjithshme të rendit publik, por nuk diskutoi dëmtimin e Kishës Ortodokse Serbe në Podujevë/Podujevo më 27 qershor 2010¹²⁶ gjatë mbledhjes së mbajtur më 15 tetor 2010, që ishte e para që nga incidenti.

Në Prishtinë/Priština, ndonëse komunitetet joshumicë në komunë u përfaqësuan – domethënë serbët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, egjiptianët e Kosovës, turqit e Kosovës, romët e Kosovës, ashkalinjtë e Kosovës dhe goranët e Kosovës – ata nuk morën pjesë rregullisht në mbledhje. Përfaqësuesi serb i Kosovës dhe ai turk i Kosovës u ankuan se nuk kishin pranuar ftesat me kohë¹²⁷, ndërsa anëtari i Kosovës u ankua që çështjet e ngritura nuk adresohen gjithmonë ashtu siç duhet nga ana e KKSBB-së.¹²⁸ I vetmi KLSP në komunë, në fshatin e përzier Donja Brnjica/Bërnice e Poshtme ku jetojnë shqiptarët dhe serbët e Kosovës, u përfaqësua. Çështjet e përgjithshme të rendit publik dhe sigurisë u diskutuan, por nuk u theksuan incidentet e veçanta ndaj komuniteteve joshumicë. Përkthimi i materialeve në gjuhën serbe u sigurua rregullisht.

Në Shtime/Štimlje, u emëruan përfaqësuesit ashkali dhe romë në KKSBB, por pjesëmarrja e tyre ishte e parregullt. Përfaqësuesi romë në KKSBB, i cili mori pjesë vetëm në 4 nga 16 mbledhjet e mbajtura, pohoi se ai nuk kishte pranuar ftesat zyrtare për të gjitha mbledhjet e organizuara. Megjithatë, ai theksoi se çështjet e rendit publik që kanë prekur komunitetin e tij ishin adresuar në mënyrë të suksesshme.¹²⁹ Anëtari ashkali i KKSBB-së mori pjesë në shumicën e mbledhjeve dhe përkundër faktit që KKSBB-ja dështoi që të zgjidhte menjëherë një shqetësim të rendit publik që preku komunitetin e tij, ai lavdëroi vlerën e tij si një mekanizëm pjesëmarrës.¹³⁰ KKSBB-ja në Shtime/Štimlje është shumë aktive, duke organizuar gjashtëmbëdhjetë mbledhje gjatë vitit 2010, që është përtej dhjetë takimeve të obligueshme në vit. Megjithatë, KKSBB-ja dështoi që të përqendrohej në çështje më serioze që prekin komunitetet joshumicë, dhe u përqendruar më shumë në çështjet si aksidentet e komunikacionit.

4.5. Rajoni i Prizrenit

Në rajonin e Prizrenit, KKSBB-të u themeluan në pesë nga gjashtë komuna. Në komunën e Rahovecit/Orahovac, ndonëse KKSBB-ja u themelua zyrtarisht, nuk u organizua asnjë mbledhje gjatë vitit 2010. Në Mamuşa/Mamushë/Mamuša, u mbajt një mbledhje në shtator të vitit 2010 për të diskutuar themelimin e një KKSBB, por nuk ka pasur vazhdimësi të saj. Katër KKSBB-të funksionale zbatuan detyrat e tyre me shkallë të ndryshme të respektimit të standardeve të zbatueshme. KKSBB-ja në

¹²⁵ Përfaqësuesi ashkali dhe përfaqësuesi romë i KKSBB-së në Podujevë/Podujevo, qyteti i Podujevës/Podujevo, intervista personale më 14 janar 2011.

¹²⁶ Shih fusnotën 61, *më sipër*.

¹²⁷ Përfaqësuesi turk i Kosovës dhe përfaqësuesi serb i Kosovës i KKSBB-së në Prishtinë/Priština, zyrat e OSBE-së në komunën e Prishtinës/Priština, intervistë personale, gjegjësisht telefonike më 18 janar 2011.

¹²⁸ Përfaqësuesit ashkali të Kosovës të KKSBB-së në Prishtinë/Priština, zyrat e OSBE-së në komunën e Prishtinës/Priština, intervista personale më 17 janar 2011.

¹²⁹ Anëtari rom i Kosovës i KKSBB-së në Shtime/Štimlje, qyteti i Shtimes/Štimlje, intervistë personale më 11 janar 2011.

¹³⁰ Anëtari ashkali i Kosovës i KKSBB-së në Shtime/Štimlje, Shtime/Štimlje, intervistë personale më 19 janar 2011.

Dragash/Dragaš u mbledh vetëm një herë gjatë vitit 2010, në Malishevë/Mališevo u mbajtën nëntë mbledhje dhe në Prizren dhe Suharekë/Suva Reka u mbajtën pesë mbledhje. Mbledhjet e KKSBB-ve në Prizren, Dragash/Dragaš dhe Suharekë/Suva Reka u kryesuan nga kryetarët gjegjë, ndërsa në Malishevë/Mališevo këto detyra iu deleguan zyrtarëve tjerë komunalë. Vetëm KKSBB në Prizren dhe Suharekë/Suva Reka ia dërgojnë procesverbalin e mbledhjeve të tyre ministrive gjegjëse për shqyrtim, kurse vetëm KKSBB-ja në Prizren i raporton kuvendit komunal, megjithëse në baza *ad hoc*. Asnjë KKSBB në rajon nuk ka hartuar ndonjë plan veprimi komunal për sigurinë e bashkësive për vitin 2010. KKSBB-ja në Suharekë/Suva Reka ka mbajtur një prej dy mbledhjeve publike konsultative të obligueshme, ndërsa tre KKSBB tjera funksionale nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje. Vetëm një grua mori pjesë në mekanizëm, duke përfaqësuar komunitetin boshnjak të Kosovës në KKSBB e Prizrenit.

Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në KKSBB-të e rajonit dhe pjesëmarrja e tyre efikase ndryshon nga një komunë në tjetrën, duke ndikuar kështu në kapacitetin e mekanizmit që në mënyrë efikase të zgjidhë shqetësimet e tyre të sigurisë dhe rendit publik. Në KKSBB në Dragash/Dragaš, të gjitha komunitetet joshumicë në komunë u përfaqësuan dhe një boshnjak i Kosovës dhe një goran i Kosovës morën pjesën në mbledhjen e vetme të mbajtur në vitin 2010. Megjithatë, fakti që përfaqësuesi boshnjak i Kosovës është njëkohësisht edhe përkthyes i komunës hap çështjen e konfliktit të interesit të mundshëm, duke qenë se ai gjendet në listën komunale të pagave. Ky person ka përkthyer, duke qenë se gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare e komunës, dhe përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë kanë kontribuar dhe kanë marrë pjesë plotësisht. Megjithatë, u paraqitën shqetësime rreth nevojës për mbajtjen e mbledhjeve më të shpeshta dhe për adresimin më sistematik të çështjeve të rendit publik dhe sigurisë që kishin prekur komunitetet joshumicë.¹³¹ I vetmi KLSP në komunë, në fshatin e përzier etnikisht të Krushevs/Kruševo, përfaqësohet në KKSBB.

Në komunën e Malishevës/Mališevo, KKSBB-ja përfshiu një përfaqësues rom të Kosovës. Komuniteti ashkali nuk është përfaqësuar. KKSBB-ja u mor me çështjet e rendit publik dhe shëndetësisë por nuk diskutoi çështjet e veçanta të sigurisë që prekën komunitetin e vogël romë të Kosovës.¹³² Kjo gjë mund të shpjegohet pjesërisht me mungesën e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në këtë mekanizëm.

KKSBB-ja në Prizren përfshin përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, komunitetit boshnjak të Kosovës, komunitetit turk të Kosovës dhe komunitetit romë të Kosovës, por këta nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Nuk janë emëruar përfaqësuesit e komunitetit ashkali dhe atij egjiptian të Kosovës. Sikurse me gjendjen në Dragash/Dragaš, shumica e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë të KKSBB-së ishin zyrtarë komunalë. KKSBB-ja në Prizren u mor kryesisht me çështjet e përgjithshme të rendit publik dhe njohuria për punën e tij ishte shumë e ulët ndër komunitetet joshumicë. Përfaqësuesi serb i Kosovës theksoi që adresimi i dobët i çështjeve të parashtruara gjatë mbledhjeve të KKSBB-së kishte një ndikim negativ në efikasitetin e tij dhe ai ndiente se nuk po i kushtohej vëmendje e mjaftueshme çështjeve në lidhje me komunitetin e tij. Për shembull, nuk pati ndonjë diskutim për vjedhjen në Kishën Ortodokse Serbe në fshatin Novake/Novak në prill të vitit 2010¹³³, ose zjarret që prekën

¹³¹ Përfaqësuesit goranë dhe boshnjak të Kosovës të KKSBB-së në Dragash/Dragaš, Dragash/Dragaš, intervista personale, më 12, gjegjësisht 13 janar 2011.

¹³² Sipas monitorimit të rregullt të OSBE-së në komunën e Malishevës/Mališevo.

¹³³ Shih f. 16, *më sipër*.

shtëpitë e serbëve të Kosovës në qytetin e Prizrenit në maj dhe korrik të vitit 2010.¹³⁴ Ai shtoi që përkthimi në gjuhën serbe gjatë mbledhjeve nuk ishte gjithmonë i mirë, ndonëse kjo gjë nuk kishte ndikuar shumë në aftësinë e tij për të marrë pjesë.¹³⁵ Një përfaqësuese femër boshnjake e Kosovës theksoi që përkthimi i materialeve në gjuhën boshnjake nuk u sigurua për shkak të mungesës së pretenduar të burimeve, përkundër faktit se kjo gjuhë është gjuhë zyrtare në komunë. Ajo gjithashtu theksoi mungesën e adresimit të mëtutjeshëm sistematik nga KKSBB-ja në lidhje me çështjet që parashtrohen gjatë mbledhjeve.¹³⁶ Përfaqësuesi i dytë boshnjak i Kosovës në KKSBB theksoi se sigurohet përkthimi i njëkohësishëm në gjuhën boshnjake dhe atë turke.¹³⁷ Përfaqësuesi romë i Kosovës theksoi që KKSBB-ja, në mënyrë të duhur, ka adresuar çështjet që kanë prekur komunitetin e tij por shtoi se ekziston nevoja për inkurajimin e pjesëmarrjes më proaktive dhe më efektive të komunitetit në këtë mekanizëm.¹³⁸ I vetmi KLSP në komunë, që gjendet në fshatin e përzier etnikisht Mushnikovë/Mušnikovo, nuk u përfaqësua në KKSBB.

Në Suharekë/Suva Reka, një ashkali përfaqësoi komunitetin e tij dhe komunitetin më të vogël romë në komunë, duke mos përfaqësuar këtë të fundit në mënyrë të mirëfilltë. KKSBB-ja u mor me disa çështje të komuniteteve joshumicë në vitin 2010, duke përfshirë implikimet e sigurisë për veprimtaritë në vazhdim e sipër dhe atyre të planifikuara në lidhje me kthimin e serbëve të Kosovës, si dhe çështjet e rendit publik që kanë prekur komunitetin ashkali. Anëtari ashkali i KKSBB-së, një pjesëmarrës i rregullt dhe aktiv, theksoi nevojën e fuqizimit të mekanizmit. Në veçanti, ai theksoi mungesën e një plani komunal të veprimit për sigurinë e bashkësive, gjë që ai beson se ka ulur KKSBB në një mekanizëm për shkëmbimin e informatave e jo për zgjidhjen efektive të problemeve.¹³⁹

¹³⁴ Shih fusnotën 64, *më sipër*.

¹³⁵ Anëtari serb i Kosovës i KKSBB-së në Prizren, ndërtesa e komunës së Prizrenit, intervistë personale më 14 janar 2011.

¹³⁶ Anëtari boshnjak i Kosovës i KKSBB-së në Prizren, ndërtesa e komunës së Prizrenit, intervistë personale më 18 janar 2011.

¹³⁷ Anëtari boshnjak i Kosovës i KKSBB-së në Prizren, ndërtesa e komunës së Prizrenit, intervistë personale më 20 janar 2011.

¹³⁸ Anëtari romë i Kosovës i KKSBB-së në Prizren, ndërtesa e komunës së Prizrenit, intervistë personale më 20 janar 2011.

¹³⁹ Anëtari ashkali i KKSBB-së në Suharekë/Suva Reka, Suharekë/Suva Reka, intervistë personale më 19 janar 2011.

5. PËRFUNDIM

Komunitetet joshumicë në Kosovë vazhdojnë që të jenë negativisht të ndikuar nga incidentet serioze të sigurisë, cak i së cilave janë personat, prona private dhe vendet e rëndësishme fetare dhe kulturore. Incidentet e tilla shpesh kanë një ndikim negativ për gjendjen e perceptuar dhe reale të sigurisë dhe rendit publik, dhe në disa raste ato mund të kufizojnë lirinë e tyre të lëvizjes dhe mund të pengojnë qasjen e tyre në të drejtat dhe shërbimet themelore.

Nëpërmjet monitorimit sistematik dhe një gamë intervistash me hisedarët gjegjë, ky raport ka shqyrtuar reagimet komunale ndaj incidenteve serioze të sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë në Kosovë.¹⁴⁰ Të gjeturat tregojnë një ndërlidhje të qartë ndërmjet reagimeve komunale dhe perceptimet e komuniteteve për sigurinë dhe rendin publik të tyre. Në ato komuna ku mekanizmat, zyrat dhe zyrtarët gjegjë kanë reaguar në mënyrë aktive ndaj incidenteve të sigurisë, nëpërmes dënimit publik ose veprimtarive sensibilizuese, ose të dyja, komunitetet e prekura kanë raportuar se perceptimi i tyre i gjendjes së sigurisë ishte përmirësuar.

Duke marrë parasysh këtë ndërlidhje të rëndësishme, duhet bërë përpjekje më të mëdha për të siguruar që reagimet efektive komunale ndaj incidenteve serioze të sigurisë nuk mbesin vetëm zyrtarisht të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullatore, por që ato zbatohen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në nivel komunal.

Korniza aktuale ligjore nuk përshkruan sa duhet reagimet specifike komunale ndaj incidenteve të sigurisë. Korniza legjislative përcakton që KKSB duhet themeluar në të gjitha komunat e Kosovës¹⁴¹, dhe mandati i tyre përcakton që ato – në bashkëpunim me policinë – duhet të shqyrtojnë dhe të zgjidhin të gjitha çështjet e sigurisë të komuniteteve.¹⁴² Megjithatë, nuk ekzistojnë udhëzime se si duhet të bëhet kjo gjë. Në vend të kësaj, vendimet merren nga zyrtarët komunalë, gjë që rezulton me praktika të ndryshme në tërë Kosovën. Ndërlidhja ndërmjet reagimeve komunale dhe perceptimit të komuniteteve joshumicë për sigurinë e tyre e bën të qartë rolin jetik që një mekanizëm i tillë mund dhe duhet ta ketë në tërë Kosovën. Siç u theksua më herët, Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar “Strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për siguri në bashkësi, 2011–2016”¹⁴³. Ky dokument nuk përcakton udhëzime të hollësishme për atë se si komunat duhet të reagojnë pas një incidenti të sigurisë.¹⁴⁴

Vlerësimi ka nënvizuar se në shumë raste kur komuna ka reaguar ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet joshumicë përmes aktiviteteve të komunikimit, dënimit publik apo diskutimit në forume komunale të sigurisë, apo në kombinime të këtyre tri

¹⁴⁰ Ndonëse në mënyrë aktive kërkon të fusë perspektivën gjinore në aktivitetet e saja të monitorimit dhe raportimit, gratë e komuniteteve joshumicë jo vetëm që janë të nënpërfaqësuar në organet komunale por edhe në forumet udhëheqëse në fshat dhe në bashkësi. Gjithashtu, ndjeshmëria e çështjeve të sigurisë ka vështirësuar edhe më tej konsultimet më të gjera lidhur me këto çështje. Duhet të theksohet se edhe viktimat dhe kryerësit e pohuar të shumicës së incidenteve të raportuar që prekin komunitetet joshumicë ishin meshkuj.

¹⁴¹ Neni 1 i udhëzimit administrativ nr. 08/2009 MPB, shih shënimin 3, *më sipër*; Neni 7.2 i Ligjit për policinë, shih shënimin 5 *më lart*.

¹⁴² Po aty, neni 3(2) i udhëzimit administrativ nr. 08/2009.

¹⁴³ Shih f. 4, *sipër*.

¹⁴⁴ Shih f. 5, *më sipër*.

opsioneve, ka pasur ndikim pozitiv në perceptimet e komuniteteve të prekura lidhur me sigurinë e tyre. Megjithatë, raporti po ashtu gjeti që shumë KKSБ дёshtuan që të respektojnë këtë detyrim për të siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës të komuniteteve, gjë që mund të shpjegojë mungesën e përgjithshme të vëmendjes ndër KKSБ për incidentet e sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë. Në lidhje me KKSБ që kanë дёshtuar të sigurojnë një përfaqësim të plotë, vlerësimi ka gjetur që komunitetet më të vogla, si kroatët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, malazezët e Kosovës, egjiptianët, romët dhe ashkalinjtë dhe goranët e Kosovës, ishin më së paku të përfaqësuar ose aspak të përfaqësuar. Për më tepër, edhe kur adresohen incidentet e sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë parregullsia e mbledhjeve të KKSБ-ve, dhe në disa raste pjesëmarrja e parregullt e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë – që shpesh ndodh për shkak të faktorëve të ndryshëm, si vështirësitë në lidhje me transportin dhe me mospranimin e ftesave – zvogëlojnë mundësitë për reagim ndaj incidenteve të tilla me kohë dhe në mënyrë sistematike. Gjithashtu, duhet të theksohet se në kundërshtim me dispozitat ligjore, në disa raste përfaqësuesit individual të KKSБ-ve – shpeshherë serbë të Kosovës – janë emëruar për të përfaqësuar disa komunitete joshumicë. Këta faktorë mund të shpjegojnë pjesërisht përse shkalla e reagimeve ndaj incidenteve të sigurisë ka qenë shumë më e lart kur ato kanë prekur serbët e Kosovës; në përgjithësi, u kushtohet më pak vëmendje incidenteve që kanë pasur si cak komunitetet tjera – si kroatët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, egjiptianët, romët dhe ashkalinjtë e Kosovës.

Duke lëvizur nga çështja e respektimit të legjislacionit dhe të politikave drejt çështjes së dytë të funksionimit praktik të KKSБ-ve, vlerësimi gjeti që, përkundër mungesës së një detyrimi të qartë ligjor për të bërë një gjë të tillë, ka pasur disa shembuj të reagimit proaktiv komunal ndaj incidenteve serioze të sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë. Këto ishin në formën e dënimit publik në masmedian lokale, në ueb faqen komunale ose gjatë mbledhjeve komunale, si dhe nëpërmjet veprimtarive sensibilizuese me komunitetet e prekura.

Siç u theksua më lart, në rastet kur një komunë ka дёnuar publikisht një incident serioz të sigurisë, përfaqësuesit e komunitetit theksuan në mënyrë të qëndrueshme ndikimin pozitiv për sigurinë e perceptuar për komunitetin e prekur. Megjithatë sensibilizimi ka qenë ndonjëherë problematik, për shembull kur deklaratat për shtyp janë lëshuar për masmedian vetëm në gjuhën shqipe ose serbe e jo në gjuhën e komunitetit të prekur, gjë që ka kufizuar ndikimin e tyre pozitiv te komuniteti i prekur.

Përfaqësuesit e komunitetit gjithashtu theksuan që dënimi publik ishte shumë më pak efikas në rastet kur ai nuk është përcjellur me veprimtari pasuese sensibilizimi për komunitetin e prekur. Në mënyrë të përsëritur, përfaqësuesit kanë identifikuar nevojën që institucionet duhet të ndërmarrin veprimtari sensibilizuese dhe që të inkurajojnë dialogun e mirëfilltë me komunitetet e prekura, përveç lëshimit të deklaratave publike denoncimi.

Përkundër niveleve të ndryshme të efikasitetit të KKSБ-ve për të reaguar në mënyrë efektive ndaj incidenteve serioze të sigurisë që kanë prekur komunitetet joshumicë, të gjithë personat e intervistuar u pajtuan për vlerën e përgjithshme të mekanizmit dhe për nevojën e fuqizimit të kapaciteteve të tija. Është përgjegjësi e vetë komunave që të hartojnë dhe që të zbatojnë reagime të bazuara në komunitetet ndaj incidenteve të sigurisë, të cilat janë sistematike dhe përfshirëse. Për dallim prej praktikave më të mira

që dalin nga ky raport, këto reagime nuk kanë përfshirë gjithmonë deklarata të qarta të dënimit që janë të qasshme për të gjitha komunitetet e prekura. Përveç kësaj, komunat nuk kanë ndërmarrë në mënyrë të qëndrueshme veprimtari sensibilizuese që sjellin së bashku komunitetet joshumicë dhe shumicë, dhe që adresojnë aspektet e perceptuara dhe reale të sigurisë dhe rendit publik për të gjithë banorët e komunës. Duke përdorur KKSBB-të në mënyrë të plotë dhe efikase, pra si forume për lehtësimin e dialogut ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve, mund të zhvillohen reagime të qëndrueshme dhe kuptimplote ndaj incidenteve të sigurisë që do të krijojnë besim ndërmjet komuniteteve të Kosovës dhe që do të funksionojnë drejt një paqeje të qëndrueshme.

6. REKOMANDIMET

Për kryetarët e komunave/kryesuesit e KKSBB-ve:

- Të themelojnë shpejtë një KKSBB në të gjitha komunat e mbetura
- Aty ku KKSBB-të janë themeluar, të sigurohet se ky organ kryesor komunal konsultativ:
 - siguron barazinë gjinore dhe përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve joshumicë që banojnë në komunë si dhe të gjithë hisedarëve të tjerë relevantë;
 - rregullisht kryesohet nga kryetari i komunës;
 - takohet së paku dhjetë herë në vit dhe mban dhe dërgon procesverbalet e të gjitha takimeve te ministritë përkatëse për të lehtësuar aktivitetin e tyre të monitorimit, përdërisa kryetari i komunës i jep llogari për aktivitetet e tij kuvendit komunal;
 - konsultohet me Këshillat Lokalë për Siguri Publike dhe Ekipet Vepruese të Sigurisë në Bashkësi;
 - mban së paku dy takime publike konsultative me komunitetet çdo vit për t'i diskutuar dhe trajtuar shqetësimet e sigurisë;
 - ofron përkthim adekuat për komunitetet joshumicë për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të papenguar në organ (përfshirë përkthimin gjuhësor gjatë takimeve dhe përkthime me shkrim të ftesave, agjendave dhe materialeve);
 - harton planin vjetor të veprimit për sigurinë në bashkësi për ta prezantuar në kuvendin komunal;
 - kryen aktivitete përcjellëse sistematike për çështjet e sigurisë të cilat i prekin komunitetet joshumicë.
- Siguron mbështetje adekuate financiare për KKSBB-të përmes dorëzimit të kërkesave për financim te kuvendi komunal apo organizatat tjera qeveritare apo joqeveritare për projekte dhe aktivitete të lidhura me sigurinë në bashkësi;
- Kryen aktivitete komunikuese, informative dhe të ngritjes së vetëdijes në lidhje me ekzistimin dhe mandatin e KKSBB-ve;
- Siguron bashkëpunim dhe bashkërendim efektiv ndërmjet KKSBB-ve dhe akterëve të tjerë komunalë përgjegjës për promovimin e tolerancës ndërmjet komuniteteve dhe zbatimin e masave të krijimit të besimit, si dhe për krijimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve tjera komunale, duke përfshirë; zëvendëskryetarin e komunës për komunitete, zëvendëskryesuesit e kuvendit komunal për komunitete, komitetet për komunitete dhe zyrtar komunal për komunitete dhe kthim;

- Shfaq përkushtim në mbrojtjen dhe promovimin e sigurisë së komuniteteve joshumicë duke sajuar dhe zbatuar reagime sistematike ndaj incidenteve të rëndësishme të sigurisë që prekin të gjitha komunitetet joshumicë, duke përfshirë:
 - Nxjerrjen e deklaratave publike për dënimin e akteve të cilat shtrihet te të gjitha komunitetet, duke përfshirë në gjuhët e komuniteteve joshumicë dhe në mediat lokale të komunitetit joshumicë;
 - Zbatimin e aktiviteteve domethënëse të komunikimit në bashkëpunim të ngushtë me zyrat përkatëse komunale dhe komunitetet e prekura për të promovuar dialog ndërmjet komuniteteve, si dhe në mes të komuniteteve dhe institucioneve, duke përfshirë policinë;
 - Sigurimin se KKSBB-të në mënyrë sistematike dhe efektive trajtojnë të gjitha incidentet e sigurisë që prekin komunitetet joshumicë.
- Lehtëson shkëmbimin e informatave dhe praktikave të mira në lidhje me reagimet proaktive komunale ndaj incidenteve të rënda të sigurisë që prekin pjesëtarët e komuniteteve joshumicë nëpër komuna (p.sh. në formë të dënimit publik në mediat lokale, në faqet e internetit të komunave apo gjatë takimeve komunale; si dhe aktivitetet e komunikimit me komunitetet e prekura);
- Në mënyrë aktive kërkon udhëzime të mëtejme nga ministrinë përkatëse në lidhje zbatimin e kornizës ligjore lidhur me punën e KKSBB-ve.

Për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të KKSBB-ve:

- Të marrin pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet dhe që të përfshijnë në rendin e ditës çështjet e sigurisë dhe rendit publik që prekin komunitetet e tyre;
- Të nisin, në mënyrë proaktive, dhe të marrin pjesë plotësisht në diskutimet për sigurinë dhe rendin publik të komuniteteve të tyre;
- Të paraqesin shqetësimet e sigurisë dhe rendit publik të komuniteteve të tyre nëpërmes komunës, si dhe që të konsultohen rregullisht me atë në lidhje me sigurinë dhe rendin publik të tyre.

Për aktorët ndërkombëtarë dhe vendas të sigurisë:

- Të inkurajojnë, mbështesin dhe bashkërendojnë me institucionet komunale reagimet e përshtatshme dhe me kohë ndaj incidenteve të rëndësishme që prekin të gjitha komunitetet joshumicë;
- Të paraqesin në mënyrë sistematike incidentet serioze që prekin të gjitha komunitetet joshumicë gjatë çfarëdo ndërveprimi me institucionet komunale, posaçërisht gjatë mbledhjeve të KKSBB-së.

**SHTOJCA I: PASQYRË E KËSHILLAVE KOMUNALË PËR SIGURI NË
BASHKËSI (KKSBB)**

RAJONI	KOMUNA	E THEMELUAR	Numri i mbledhjeve në vitin 2010	Komunitetet joshumicë të cilat u përfaqësuan	Komunitetet joshumicë të cilat nuk u përfaqësuan
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/Uroševac	Po	5	Serb, romë, ashkali, egjiptian	Boshnjak
	Gjilan/Gnjilane	Po	4	Serb, turk, romë	Të gjithë u përfaqësuan
	Han i Elezit/Deneral Janković	Po	10	Asnjë	Boshnjak
	Kaçanik/Kaçanik	Po	10	Asnjë	Romë
	Kamenicë/Kamenica	Po	2	Serb	Romë
	Klokot-Vrbovac/Klllokot-Vërbov	Po	5	Shqiptar	Të gjithë u përfaqësuan
	Novo Brdo/Novobërdë	Po	0	N/A	N/A
	Partesh/Partesh	Jo	N/A	N/A	N/A
	Ranilug/Ranillug	Jo	N/A	N/A	N/A
	Štrpce/Shtërpçë	Po	1	Shqiptar	Romë
	Viti/Vitina	Po	6	Serb	Kroat
Mitrovicë/Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	Jo	N/A	N/A	N/A
	Mitrovicë/Mitrovica	Po	0	Nuk është mbledhur	Nuk është mbledhur
	Skenderaj/Srbica	Po	0	Serb, ashkali	Boshnjak
	Vushtrri/Vuçitrn	Po	12	Serb, turk, romë, ashkali	Të gjithë u përfaqësuan
	Zubin Potok	Jo	N/A	N/A	N/A
	Zvečan/Zveçan	Jo	N/A	N/A	N/A
Pejë/Peć	Deçan/Dečane	Po	4	Boshnjak	Serb, egjiptian, romë
	Gjakovë/Đakovica	Po	2	Egjiptian	Boshnjak, ashkali, romë
	Istog/Istok	Po	6	Serb, boshnjak, egjiptian, romë	Malazez
	Junik	Po	1	Asnjë nuk banon	N/A
	Klinë/Klina	Po	5	Serb, ashkali, egjiptian, romë	Malazez
	Pejë/Peć	Po	8	Serb, boshnjak, egjiptian, romë	Goran, malazez
Prishtinë/Priština	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	Po	2	Serb, egjiptian, romë, ashkali	Boshnjak, goran
	Glllogoc/Glogovac	Po	4	Asnjë nuk banon	N/A
	Gracanica/Gračanicë	Jo	N/A	N/A	N/A
	Lipjan/Lipljan	Po	8	Serb, turk, romë, ashkali, malazez, kroat	Të gjithë u përfaqësuan
	Obiliq/Obilić	Po	3	Serb, boshnjak, egjiptian, romë, ashkali	Malazez
	Podujevë/Podujevo	Po	3	Romë, ashkali	Serb
	Prishtinë/Priština	Po	5	Serb, boshnjak, egjiptian, romë, ashkali, turk, goranë	Të gjithë u përfaqësuan

	Shtime/Štimlje	Po	16	Romë, ashkali	Të gjithë u përfaqësuan
Prizren	Dragash/Dragaš	Po	1	Boshnjak, goranë	Të gjithë u përfaqësuan
	Malishevë/Mališevo	Po	9	Romë	Ashkali
	Mamuša/Mamushë/Mamuša	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prizren	Po	5	Serb, boshnjak, turk, romë	Egjiptian, ashkali
	Rahovec/Orahovac	Po	0	Nuk është mbledhur	Nuk është mbledhur
	Suharekë/Suva Reka	Po	5	Ashkali	Serb, Romë

* Pilot njësi komunale deri në gusht të vitit 2008